FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 114

Tiranë – E premte, 2 gusht 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 549, datë 31.7.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", të ndryshuar	8515
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 552, datë 31.7.2019	Për miratimin e rregullit teknik "Për përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"	8516
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019	Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive	8550
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 555, datë 31.7.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 286, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm, të cilët punësohen nga Agjencitë e Punësimit të Përkohshëm"	8554
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 556, datë 31.7.2019	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Këshilli i Ministrave te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të pasurisë me emërtimin "Godinë restorant dy kate, stabiliment Durrës", dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare"	8555
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.557, datë 31.7.2019	Për disa shtesa në vendimin nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, 'Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë'"	8556

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 558, datë 31.7.2019	Për një shtesë fondi në buxhetin e viti 2019, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.....	8567
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 31.7.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore"	8567
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 560, datë 31.7.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 768, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i venddepozitimit sanitar të mbetjeve në afërsi të Maliqit dhe rrugës hyrëse, qarku Korçë"	8568
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 561, datë 31.7.2019	Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", Shkodër, për vitin shkollor 2019–2020.....	8569
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 562, datë 31.7.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë"	8569
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 563, datë 31.7.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar", të ndryshuar.....	8570
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 31.7.2019	Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij.....	8571
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 565, datë 31.7.2019	Për përcaktimin e buxhetit fillestar të strukturës së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.....	8573
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.566, datë 31.7.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij", të ndryshuar.....	8573
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 567, datë 31.7.2019	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Bibliotekës Kombëtare.....	8576
	Vendim (*i shkurtuar*) për shpalljen të vdekur të shtetasit Thoma Lashi.....	8576
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Fatmir Skënderi.....	8576

VENDIM
Nr. 549, datë 31.7.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike".

b) Në fund të shkronjës "a", të pikës 1/3, shtohet emërtesa "Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore".

c) Në shkronjën "b", të pikës 1/3:

i. shtohen emërtesat "Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve" dhe "Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit";

ii. shfuqizohen emërtesat "Agjencia e Shërbimit Arkeologjik" dhe "Instituti i Monumenteve të Kulturës";

iii. emërtesa "Muzeu Kombëtar "Gjethi" zëvendësohet me emërtesën "Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"";

iv. emërtesa "Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" zëvendësohet me emërtesën "Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".

ç) Në shkronjën "c", të pikës 1/3:

i. shtohet emërtesa "Qendra Muzeore Durrës";

ii. emërtesa "Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat" zëvendësohet me emërtesën "Qendra Muzeore Berat - Muzeu i Ikonografisë "Onufri", Muzeu Etnografik Berat";

iii. emërtesa "Muzeu Kombëtar "Gjergj Kastrioti" Krujë" zëvendësohet me emërtesën "Qendra Muzeore Krujë - Muzeu Kombëtar "Skënderbeu", Muzeu Etnografik Krujë";

iv. emërtesa "Muzeu Kombëtar i Pavarësisë Vlorë" zëvendësohet me emërtesën "Muzeu Kombëtar i Pavarësisë";

v. emërtesa "Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë" zëvendësohet me emërtesën "Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar";

vi. emërtesa "Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore" zëvendësohet me emërtesën "Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore";

vii. emërtesa "Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike" zëvendësohet me emërtesën "Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale";

viii. shfuqizohet emërtesa "Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit".

d) Pika 4/2 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

"4/2. Në Kryeministri, nëpunësit civilë në pozicionet, "Drejtor i Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes", "Drejtor i Departamentit Rregullator dhe Përputhshmërisë", "Drejtor i Departamentit të Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit", "Drejtor Njësie, Jurist dhe Koordinator në Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë", "Drejtor Njësie, Drejtor Drejtorie dhe Koordinator në Departamentin e

Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes", "Drejtor njësie dhe Koordinator në Njësinë e Transparencës dhe Antikorrupsionit", "Drejtor i Njësisë së Burimeve Kombëtare për Zhvillim", "Drejtor i Njësisë së Buxhetit dhe Administrimit", "Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Brendshëm" dhe "Koordinator në Sektorin (Zyrën) e Menaxhimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm", në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.".

dh) Në pikën 5, pas fjalëve "Specialist redaktor në Kuvendin e Shqipërisë" shtohen fjalët "dhe "Specialist stenograf redaktor në administratën e Presidentit".

e) Në lidhjen nr.6/5, që përmendet në pikën 9.5, shtohen dy rreshta, me këtë përmbajtje:

Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes	III-a	1	20 000
Drejtor drejtorie në drejtoritë mbështetëse	III-a	1	0

2. Zbatimi i këtij vendimi dhe efektet financiare që rrjedhin prej tij, për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe të fillojnë nga:

i) momenti i transferimit apo emërimit të nëpunësve/punonjësve në strukturat dhe organikat e reja të institucioneve të përmendura në shkronjat "b", "c" dhe "ç", të pikës 1, të këtij vendimi;

ii) momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për të gjitha përcaktimet e tjera.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 552, datë 31.7.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK "PËR PËRPUTHSHMËRINË ELEKTROMAGNETIKE TË PAJISJEVE DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA"[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 10489, datë 15.12.2011, "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik "Për përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilëve janë përshirë në listën bashkëlidhur këtij vendimi, shërbejnë si dokumente referencë për prezumimin e konformitetit të përputhshmërisë elektromagnetike të pajisjeve me kërkesat thelbësore të objektivave të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Çdo pajisje e vendosur në treg, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe në përputhje me vendimin nr. 1054, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik "Për përputhshmërinë elektromagnetike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"", nuk do të pengohet që të bëhet e disponueshme në treg, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Edhe certifikatat e lëshuara në përputhje me vendimin nr. 1054, datë 23.12.20015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik "Për përputhshmërinë elektromagnetike dhe përcak-

[1] *Ky vendim është përafruar pjesërisht me direktivën 2014/30/EU, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 26 shkurt 2014, "Për harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare në lidhje me përputhshmërinë elektromagnetike".*

Numri CELEX 32014L0030, Numri i "Fletores zyrtare" l 96/79.

timin e listës së standardeve të harmonizuara””, janë të vlefshme pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Vendimi nr. 1054, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullit teknik "Për përputhshmërinë elektromagnetike dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara"", shfuqizohet.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLI TEKNIK
PËR PËRPUTHSHMËRINË ELEKTROMAGNETIKE DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË HARMONIZUARA

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Ky rregull teknik (këtu e në vijim referuar si: "Rregull") përcakton rregullat për përputhshmërinë elektromagnetike të pajisjeve dhe ka për qëllim të sigurojë funksionimin e tregut, duke kërkuar që pajisja të respektojë nivelin e duhur të përputhshmërisë elektromagnetike.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky rregull zbatohet për pajisjet e përcaktuara në nenin 3, të këtij rregulli.

2. Ky rregull nuk zbatohet për:

a) pajisjet që bien në fushën e zbatimit të rregullit teknik për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve;

b) produktet, pjesët dhe aplikimet aeronautike;

c) pajisjet radio të përdorura nga radioamatorët, nëse pajisjet nuk janë bërë të disponueshme në treg. Pjesët përbërëse që montohen nga radioamatorët dhe pajisjet tregtare të modifikuara dhe të përdorura nga radioamatorët nuk konsiderohen pajisje të disponueshme për treg;

ç) pajisje, natyra e karakteristikave fizike e të cilave është e tillë që:

i) të mos gjenerojnë ose kontribuojnë në emetime elektromagnetike që tejkalojnë nivelin e lejuar për pajisjet radio dhe telekomunikacion gjatë funksionimit, sipas qëllimit të paracaktuar; dhe

ii) të funksionojnë normalisht sipas qëllimit të paracaktuar të përdorimit dhe të mos përkeqësohet në mënyrë të papranueshme në prani të ndërhyrjes elektromagnetike.

3. Nëse për pajisjen e përmendur në pikën 1, të këtij neni, kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, parashikohen pjesërisht ose plotësisht në mënyrë specifike me legjislacion tjetër, ky rregull nuk zbatohet, ose pushon së zbatuari, për ato pajisje në lidhje me këto kërkesa, nga data e zbatimit të legjislacionit specifik.

4. Ky rregull nuk ndikon në zbatimin e legjislacionit që rregullon sigurinë e pajisjeve.

Neni 3
Përkufizimet

1. Për qëllime të këtij rregulli teknik, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. "Pajisje", çdo aparat ose instalim i palëvizshëm.

2. "Aparat", çdo mekanizëm përfundimtar ose kombinim i tyre që bëhet i disponueshëm në treg si njësi e vetme funksionale, i destinuar për përdoruesin e fundit dhe që prodhon çrregullime elektromagnetike ose funksionimi i të cilit ndikohet nga këto çrregullime.

3. "Instalim i palëvizshëm", kombinimi i veçantë i disa tipa aparatesh dhe, sipas rastit, mekanizmave të tjerë, të montuar, të instaluar dhe të destinuar për t'u përdorur në mënyrë të përhershme në një vend të paracaktuar.

4. "Përputhshmëri elektromagnetike", aftësia e pajisjes për të funksionuar në mënyrë të kënaqshme në mjedisin e saj elektromagnetik, pa shkaktuar ndërhyrje elektromagnetike të patolerueshme te pajisja tjetër në atë mjedis.

5. "çrregullim elektromagnetik", çdo fenomen elektromagnetik që mund të prishë performancën e pajisjes. Një çrregullim elektromagnetik mund të jetë zhurmë elektromagnetike, sinjal i padëshiruar ose ndryshim në vetë mediumin transmetues.

6. "Imunitet", aftësia e pajisjes që të funksionojë sipas qëllimit të paracaktuar, pa dëmtuar efektshmërinë e saj në prezencë të një çrregullimi elektromagnetik.

7. "Qëllime të sigurisë", qëllime në lidhje me masat mbrojtëse të jetës njerëzore dhe të pronës.

8. "Mjedis elektromagnetik", të gjitha fenomenet elektromagnetike të vëzhgueshme në një zonë të caktuar.

9. "Bërje e disponueshme në treg", çdo furnizim i aparatit për shpërndarje, konsumim ose përdorim në tregun shqiptar gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.

10. "Vendosje në treg", bërja e disponueshme për herë të parë e aparatit në tregun e Republikës së Shqipërisë.

11. "Prodhues", çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon një aparat ose ka një aparat të projektuar a të prodhuar dhe e tregton këtë aparat nën emrin apo markën e tij tregtare.

12. "Përfaqësues i autorizuar", çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i cili ka një akt përfaqësimi nga prodhuesi për të vepruar në emër të tij për detyra specifike të përmenduara në këtë rregull.

13. "Importues", çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që vendos një aparat nga një vend i tretë në tregun shqiptar.

14. "Shpërndarës", çdo person fizik ose juridik, i përfshirë në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit ose importuesit, që bën të disponueshëm në treg aparatin.

15. "Operator ekonomik", prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi dhe shpërndarësi.

16. "Specifikim teknik", dokumenti, ku përshkruhen kërkesat teknike që duhet të përmbushen nga një pajisje.

17. "Standard i harmonizuar shqiptar", një standard shqiptar, që transpozon një standard të harmonizuar evropian, në mbështetje të këtij rregulli, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, në bashkërendim me ministritë përgjegjëse dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në "Fletoren zyrtare".

18. "Akreditimi", është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.

19. "Organizëm kombëtar i akreditimit", organi sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për akreditimin.

20. "Vlerësim i komformitetit", procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat thelbësore të këtij rregulli, për një aparat.

21. "Organ i vlerësimit të konformitetit", çdo organ që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit, përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.

22. "Kthim i produktit", çdo masë për kthimin mbrapsht të një aparati që është bërë ndërkohë i disponueshëm te përdoruesi i fundit.

23. "Ndalim i tregtimit", çdo masë që parandalon bërjen të disponueshëm në treg të aparatit në zinxhirin e furnizimit.

24. "Markim CE", markimi me të cilin prodhuesi tregon se pajisjet elektrike janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

25. "Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut", Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

2. Për qëllime të këtij rregulli, konsiderohen aparate:

a) "Elementi përbërës" ose "Nënmontimi", i destinuar të përfshihet në një aparat nga përdoruesi i fundit, dhe që mund të prodhojë çrregullime elektromagnetike ose funksionimi i të cilave rrezikon të ndikohet prej tyre.

b) "Instalimi i lëvizshëm", i përcaktuar si kombinim i aparateve dhe, sipas rastit, mekanizmave të tjerë, të destinuar që të lëvizen dhe të funksionojnë në vendndodhje të ndryshme.

Neni 4

Bërja e disponueshme në treg dhe/ose vënia në shërbim

Pajisja bëhet e disponueshme në tregun shqiptar dhe/ose vihet në shërbim, vetëm nëse është në përputhje me këtë rregull, kur instalohet siç duhet,

mirëmbahet dhe përdoret për qëllimin që është destinuar.

Neni 5
Lëvizja e lirë e pajisjes

1. Në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk ndalohet, për arsye që lidhen me përputhshmërinë elektromagnetike, bërja e disponueshme në treg dhe/ose vënia në shërbim e pajisjes që është në përputhje me këtë rregull.

2. Kërkesat e këtij rregulli nuk pengojnë zbatimin e masave specifike të mëposhtme, që kanë të bëjnë me vënien në shërbim ose përdorimin e pajisjes, të tilla si:

a) masat për të tejkaluar një problem ekzistues ose të parashikuar të përputhshmërisë elektromagnetike në një mjedis të caktuar;

b) masat e marra për arsye sigurie për të mbrojtur rrjetet publike të telekomunikacionit apo stacione marrëse ose transmetuese, kur përdoren për qëllime sigurie, në situata me spektër të mirëpërcaktuar.

3. Masat e marra në pikën 2, të këtij neni, duhet t'i njoftohen menjëherë ministrisë përgjegjëse për tregtinë, duke dhënë detaje për llojin e masës, kohëzgjatjen dhe arsyet që justifikojnë marrjen e saj.

4. Ministria përgjegjëse për tregtinë jep opinion për masat e marra.

5. Pikat 3 dhe 4, të këtij neni, zbatohen pa cenuar parashikimet e legjislacionit në fuqi për procedurën e njoftimit në fushën e standardeve teknike dhe të rregulloreve.

6. Pajisjet që nuk janë në përputhje me këtë rregull mund të paraqiten ose demonstrohen në panaire, ekspozita ose ngjarje të ngjashme, me kushtin që një shenjë e dukshme të tregojë qartë se pajisja nuk duhet të vendoset në treg ose të vihet në përdorim derisa të sillet në përputhje me kërkesat e këtij rregulli. Demonstrimi duhet të bëhet vetëm nëse merren masat e duhura për të shmangur çrregullimet elektromagnetike.

Neni 6
Kërkesat thelbësore

Pajisja duhet të përmbushë kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, (këtu e në vijim referuar si: "Kërkesat thelbësore").

KREU II
DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË

Neni 7
Detyrimet e prodhuesit

1. Kur prodhuesi vendos aparatet në treg, siguron se ato janë projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat thelbësore, të përcaktuara në shtojcën I.

2. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik të referuar në shtojcat II ose III dhe kryen procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas parashikimeve të nenit 14, të këtij rregulli, ose kërkon kryerjen e saj.

3. Kur nga procedura e vlerësimit të konformitetit është demonstruar përputhshmëria e aparatit me kërkesat e zbatueshme, prodhuesi harton deklaratën EU të konformitetit dhe fikson markimin CE.

4. Prodhuesi mban dokumentacionin teknik dhe deklaratën EU të konformitetit për 10 vjet pasi aparatet janë vendosur në treg.

5. Prodhuesi siguron se zbatohen procedurat e nevojshme që prodhimi në seri të mbetet në konformitet me këtë rregull. Ndryshimet në projektimin ose karakteristikat e aparateve, dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara shqiptare, standardet ndërkombëtare ose kombëtare ose në specifikimet e tjera teknike, sipas të cilave është deklaruar konformiteti i aparateve, duhet të merren në konsideratë.

6. Prodhuesi siguron që aparatet e vendosura në treg prej tij të kenë të shënuar tipin, numrin serial ose një element tjetër që mundëson identifikimin e tij, ose kur madhësia dhe natyra e aparatit nuk e mundëson atë, informacioni i kërkuar vendoset në paketimin ose në dokumentet shoqëruese të aparatit.

7. Prodhuesi vendos në aparat emrin e tij, emrin e regjistruar tregtar ose markën tregtare dhe adresën postare në të cilën mund të kontaktohet ose, kur ky informacion nuk është i mundur të vendoset në pajisje, prodhuesi i vendos ato në paketimin ose dokumentet shoqëruese të tij. Adresa duhet të tregojë një pikë të vetme në të cilën mund të kontaktohet prodhuesi. Informacioni për adresën duhet të jenë në gjuhën shqipe ose në

një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e fundit dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

8. Prodhuesi siguron që aparati të shoqërohet nga udhëzime për përdorimin dhe nga informacioni i parashikuar në nenin 18, në gjuhën shqipe. Udhëzuesit dhe informacionet, si dhe etiketimi, duhet të jenë të qarta, të lexueshme dhe lehtësisht të kuptueshme.

9. Prodhuesi që konsideron ose ka arsye për të besuar se aparati që ka vendosur në treg nuk është në përputhje me këtë rregull, duhet që menjëherë të marrë masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë aparatin në përputhshmëri, ose sipas rastit, të ndalojë tregtimin apo ta kthejë atë nga tregu. Kur aparati paraqet rrezik, prodhuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke i dhënë hollësitë, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

10. Prodhuesi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, siguron të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose formë elektronike, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për të demonstruar përputhshmërinë e aparatit me këtë rregull. Prodhuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga aparati i vendosur në treg prej tij.

Neni 8
Përfaqësuesi i autorizuar

1. Prodhuesi, me një akt përfaqësimi, mund të caktojë një përfaqësues të autorizuar. Detyrimet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 7, të këtij rregulli, dhe detyrimi për të hartuar dokumentacionin teknik të referuar në pikën 2, të nenit 7, të këtij rregulli, nuk mund të jenë pjesë e aktit të përfaqësimit.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit të lëshuar nga prodhuesi. Akti i përfaqësimit duhet të lejojë përfaqësuesin e autorizuar:

a) të mbajë deklaratën EU të konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion strukturës së mbikëqyrjes së tregut për 10 vjet, pas vendosjes në treg të aparatit;

b) t'i sigurojë strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, rast të një kërkese të arsyetuar nga asaj, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për demonstrimin e përputhshmërisë së aparatit; dhe

c) të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas kërkesës të bërë nga ana e saj, për marrjen e masave për eliminimin e rreziqeve të shfaqura nga aparati, për të cilin i është lëshuar akti i përfaqësimit.

Neni 9
Detyrimet e importuesit

1. Importuesi vendos në tregun shqiptar vetëm aparate në përputhje me këtë rregull dhe legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

2. Para vendosjes së pajisjeve elektrike në treg, importuesi sigurohet që:

a) prodhuesi ka kryer procedurën e vlerësimit të konformitetit të përmendur nenin 14, të këtij rregulli, dhe ka përgatitur dokumentacionin teknik;

b) aparati të ketë markimin CE dhe të shoqërohet me dokumentet e kërkuara; dhe se

c) prodhuesi ka përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 5 dhe 6, të nenit 7, të këtij rregulli.

3. Kur importuesi konsideron ose ka arsye të besojë se aparati që ai importon nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore, ai nuk duhet ta vendosë në treg derisa ta sjellë në konformitet. Kur aparati paraqet rrezik, importuesi informon prodhuesin dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Importuesi vendos në aparat emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën postare ku mund të kontaktohet ose, kur ky informacion nuk është e mundur të vendoset në aparat, importuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentin shoqërues të tij. Të dhënat mbi adresën duhet të jenë në gjuhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë ose në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për përdoruesit e fundit dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

5. Importuesi siguron që aparati të shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin ose, sipas rastit, udhëzimet për mirëmbajtjen, si dhe nga informacioni për sigurinë në gjuhën shqipe. Udhëzuesit dhe informacioni i sigurisë, si dhe çdo

etiketim tjetër duhet të jenë të qarta, të lexueshme dhe lehtësisht të kuptueshme.

6. Importuesi siguron që gjatë kohës që aparati është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të këtij rregulli.

7. Importuesi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se aparati, të cilin ai e ka vendosur në treg, nuk është në përputhje me këtë rregull, duhet menjëherë të marrë masat e nevojshme korrigjuese për ta sjellë atë në konformitet, ose sipas rastit, të ndalojë tregtimin apo ta kthejë atë nga tregu. Kur aparati shfaq një rrezik, importuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësi, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

8. Importuesi mban, deri në 10 vjet pas vendosjes së aparatit në treg, një kopje të deklaratës EU të konformitetit dhe të dokumentacionit teknik dhe siguron që t'i vërë ato në dispozicion të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, sipas kërkesës.

9. Importuesi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose në formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të aparatit në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për këto struktura. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga pajisja elektrike e vendosur në treg prej tij.

Neni 10
Detyrimet e shpërndarësit

1. Kur apartet bëhen të disponueshme në treg, shpërndarësi duhet të veprojë me kujdesin e duhur në lidhje me respektimin e kërkesave të këtij rregulli.

2. Para bërjes së disponueshme në treg të pajisjes elektrike, shpërndarësi verifikon që:

a) aparati mban markimin CE;

b) aparati shoqërohet me dokumentacionin e kërkuar, udhëzimet dhe informacionin për sigurinë në gjuhën shqipe;

c) prodhuesi dhe importuesi kanë përmbushur kërkesat e parashikuara në nenet 7, pikat 5 e 6, dhe 9, pika 4, të këtij rregulli.

3. Kur shpërndarësi konsideron ose ka arsye për të besuar se aparati nuk është në përputhje me kërkesat thelbësore, ai nuk duhet ta bëjë të disponueshëm në treg aparatin, derisa ai të sillet në konformitet. Kur aparati shfaq rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin për rrezikun, si dhe strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

4. Shpërndarësi siguron se gjatë kohës kur aparati është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk e rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, të këtij rregulli.

5. Shpërndarësi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se aparati, të cilin ai e ka bërë të disponueshëm në treg, nuk është në përputhje me këtë rregull, siguron, nëse është e nevojshme, marrjen e masave korrigjuese për sjelljen e tij në përputhshmëri me kërkesat e këtij rregulli ose, sipas rastit, ndalimin e tregtimit apo kthimin e saj. Kur aparati paraqet rrezik, shpërndarësi informon menjëherë strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, duke i dhënë hollësi, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

6. Shpërndarësi, me kërkesë të arsyetuar të strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, i siguron atyre të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në letër ose në formë elektronike, për demonstrimin e konformitetit të aparatit. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga aparatet e vendosura në treg prej tij.

Neni 11
Rastet ku detyrimet e prodhuesit zbatohen për importuesin dhe shpërndarësin

Importuesi ose shpërndarësi konsiderohet prodhues për qëllime të këtij rregulli dhe i nënshtrohet detyrimeve të prodhuesit sipas nenit 7, të këtij rregulli, kur ai vendos një aparat në treg nën emrin ose markën e tij tregtare ose e modifikon aparatin e vendosur tashmë në treg në mënyrë të tillë që të ndikojë në përputhshmërinë e saj me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull.

Neni 12
Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë, sipas kërkesës së strukturës përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut identifikojnë:

a) çdo operator ekonomik i cili i ka furnizuar ata me aparate;

b) çdo operator ekonomik të cilin ata e kanë furnizuar me apararte.

2. Operatorët ekonomikë duhet të jenë në gjendje të paraqesin informacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, për 10 vjet pasi janë furnizuar me aparatin dhe për 10 vjet pasi kanë furnizuar aparatin.

KREU III
KONFORMITETI I PAJISJES

Neni 13
Prezumimi i konformitetit të pajisjes

Pajisja që është në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare ose pjesë të tyre, referencat e të cilave janë publikuar në Fletoren Zyrtare, prezumohet se janë në përputhje me me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, të këtij rregulli, të mbuluara nga ato standarde ose pjesë të tyre.

Neni 14
Procedurat e vlerësimit të konformitetit për aparatin

1. Vlerësimi i konformitetit të aparatit me kërkesat thelbësore të përcaktuara në shtojcën I, të këtij rregulli mund të përcaktohet me secilën nga procedurat e vlerësimit të konformitetit të mëposhtme, të përzgjedhura nga prodhuesi:

a) kontrolli i brendshëm i prodhimit i përcaktuar në shtojcën II;

b) ekzaminimi i tipit EU, i cili pasohet nga konformiteti i tipit të bazuar në kontrollin e brendshëm të prodhimit, i përcaktuar në shtojcën III.

2. Prodhuesi mund të vendosë të kufizojë zbatimin e procedurës së përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, për disa aspekte të kërkesave thelbësore, me kusht që për aspektet e tjera të kërkesave thelbësore të zbatohet procedura e përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 1, të po këtij neni.

Neni 15
Deklarata e EU e konformitetit

1. Deklarata EU e konformitetit provon se është demonstruar përmbushja e kërkesave thelbësore të përcaktuara në shtojcën I.

2. Deklarata EU e konformitetit hartohet sipas formës së përcaktuar në shtojcën IV. Ajo përmban elementet e specifikuara në modulet përkatëse të shtojcave II dhe III, të këtij rregulli, dhe përditësohet vazhdimisht. Deklarata EU e konformitetit përkthehet në gjuhën shqipe ose në një gjuhë të kërkuar nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

3. Kur aparati është objekt i zbatimit të më shumë se një akti ligjor apo nënligjor që kërkon hartimin e deklaratës EU të konformitetit, për të gjitha aktet hartohet një deklaratë e vetme konformiteti. Deklarata duhet të përmbajë identifikimin e akteve ligjore të zbatueshme, duke përfshirë referencat e tyre të botimit.

4. Me hartimin e deklaratës EU të konformitetit, prodhuesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e aparatit me kërkesat e përcaktuara në këtë rregull.

Neni 16
Parimet e përgjithshme të markimit CE

Markimi CE i nënshtrohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 17
Rregullat dhe kushtet për vendosjen e markimit CE

1.Markimi CE vendoset në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme tek aparati ose në pllakën të dhënave të tij. Kur kjo nuk është e mundur ose nuk garantohet për shkak të natyrës së aparatit, ajo vendoset te paketimi dhe te dokumentet shoqëruese.

2. Markimi CE vendoset përpara se aparati të vendoset në treg.

3. Struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, në bashkëpunim me autoritetet doganore, siguron aplikimin korrekt të regjimit që rregullon markimin CE dhe ndërmerr veprimet e duhura në rast të përdorimit të papërshtatshëm të këtij markimi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Neni 18
Informacion në lidhje me përdorimin e aparatit

1. Aparati duhet të shoqërohet me informacion për çdo masë paraprake specifike që merret për të montuar, instaluar, mirëmbajtur ose përdorur aparatin, me qëllim që të sigurohet që, kur të vihet në shërbim, ai të jetë në përputhje me kërkesat thelbësore.

2. Aparati, për të cilin përputhshmëria me kërkesat thelbësore nuk sigurohet për zonat e banuara, shoqërohet nga një pasqyrim i qartë i këtij kufizimi në përdorim dhe, sipas rastit, edhe në paketim.

3. Informacioni i kërkuar për të mundësuar përdorimin e aparatit në përputhje me qëllimin e përcaktuar përfshihet në udhëzimet që e shoqërojnë atë.

Neni 19
Instalimet e palëvizshme

1. Aparati që është bërë i disponueshëm në treg dhe që mund të inkorporohet në një instalim të palëvizshëm i nënshtrohet dispozitave përkatëse për aparatet, të parashikuara në këtë rregull.

2. Kërkesat e neneve 6 deri në 12 dhe 14 deri në 18, të këtij rregulli, nuk janë detyruese në rastin e aparateve të destinuara për t'u inkorporuar në një instalim të palëvizshëm të përcaktuar dhe që nuk janë bërë të disponueshëm në treg.

Në raste të tilla, dokumentacioni shoqërues identifikon instalimin e palëvizshëm dhe karakteristikat e tij që lidhen me përputhshmërinë elektromagnetike dhe tregon masat paraprake që duhen marrë për inkorporimin e aparatit në instalimin e palëvizshëm, me qëllim që të ruhet përputhshmëria e atij instalimi me këtë rregull. Dokumentacioni përfshin, gjithashtu, dhe informacionin e përmendur në nenet 7, pikat 6 e 7, dhe 9, pika 4, të këtij rregulli.

3. Praktikat e mira inxhinerike të përmendura në pikën 2, të shtojcës I, të këtij rregulli, dokumentohen dhe dokumentacioni mbahet nga personi ose personat përgjegjës në dispozicion të strukturës së mbikëqyrjes së tregut për inspektim, për sa kohë që instalimi i palëvizshëm është në funksionim.

4. Kur ka tregues të mospërputhshmërisë së instalimit të palëvizshëm, sidomos nëse ka ankesa për ndërhyrjet/çrregullimet elektromagnetike që gjenerohen nga instalimi, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut mund të kërkojë prova të përputhshmërisë së instalimit të palëvizshëm, dhe nëse është e nevojshme, fillimin e një vlerësimi.

5. Kur mospërputhshmëria provohet, strukturat përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut urdhërojnë personin përgjegjës për instalimin për marrjen e masave të duhura për ta sjellë instalimin e palëvizshëm në përputhje me kërkesat thelbësore.

6. Struktura përgjegjëse per mbikëqyrjen e tregut përcakton mënyrën e identifikimit të personit ose të personave përgjegjës për bërjen/arritjen e përputhshmërisë së një instalimi të palëvizshëm me kërkesat thelbësore.

KREU IV
MIRATIMI I ORGANIT TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

Neni 20
Autoriteti përgjegjës për miratimin e organit të vlerësimit të konformitetit

1.Ministri përgjegjës për tregtinë vepron si autoritet miratimi për organet e vlerësimit të konformitetit, në kuptim të këtij rregulli, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

2. Në parashikimet në vijim të këtij rregulli, termi "organ" nënkupton një organizëm të notifikuar evropian të miratuar ose një organ të miratuar shqiptar, të miratuar sipas pikës 1, të këtij neni, për çdo rast.

3. Ministri përgjegjës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore, vepron si autoritet miratues, i ngarkuar me detyrë për krijimin

dhe realizimin e procedurave të nevojshme për vlerësimin dhe njoftimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe monitorimin e organeve të miratuara, përfshirë pajtueshmërinë me nenin 24, të këtij rregulli.

Neni 21
Detyrimi për informacion mbi organet e miratuara (OM)

Ministria përgjegjëse për tregtinë publikon në faqen zyrtare të internetit dhe mban të përditësuar listën e organeve të miratuara me numrat e tyre të identifikimit, fushat për të cilat janë miratuar, periudhën e vlefshmërisë dhe çdo ndryshim të tyre.

Neni 22
Kërkesat për organet e miratuara

1. Për qëllim miratimi, një organ i vlerësimit të konformitetit duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në pikat 2 deri në 11, të këtij neni.

2. Organi i vlerësimit të konformitetit krijohet dhe ka personalitet juridik sipas legjislacionit në fuqi.

3. Organi i vlerësimit të konformitetit është një organ palë e tretë e pavarur nga organizata ose aparati që vlerëson.

Organi që i përket një shoqate biznesi ose federate profesionale që përfaqëson sipërmarrjet e përfshira në projektim, prodhim, ofrim, montim, përdorim ose mirëmbajtje të aparateve që vlerëson, mund të konsiderohet një organ i tillë, me kusht që të tregohet pavarësia dhe mungesa e një konflikti interesi.

4.Organi i vlerësimit të konformitetit, niveli i tij drejtues dhe stafi përgjegjës për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit nuk do të jetë projektuesi, prodhuesi, furnizuesi, instaluesi, blerësi, pronari, përdoruesi ose mirëmbajtësi i aparateve që ata vlerësojnë, as përfaqësuesi i njërës prej këtyre palëve. Kjo nuk pengon përdorimin e aparateve të vlerësuara që janë të nevojshme për veprimtaritë e organit të vlerësimit të konformitetit ose të përdorimit të këtyre aparateve për qëllime personale.

Organi i vlerësimit të konformitetit, niveli i tij drejtues dhe stafi përgjegjës për të kryer detyra të vlerësimit të konformitetit nuk përfshihen direkt në projektimin, prodhimin ose ndërtimin, tregtimin, instalimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e këtyre aparateve ose nuk përfaqëson palët e përfshira në këto veprimtari. Ata nuk përfshihen në veprimtari që mund të jetë në konflikt me pavarësinë e gjykimit të tyre ose integritetin në lidhje me veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit për të cilat janë miratuar. Kjo vlen në veçanti për shërbimet e konsulencës.

Organet e vlerësimit të konformitetit sigurohen që veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tyre të mos prekin konfidencialitetin, objektivitetin ose paanshmërinë e veprimtarive të tyre të vlerësimit të konformitetit.

5.Organet e vlerësimit të konformitetit dhe stafi i tyre kryejnë veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit me shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencën e kërkuar teknike në fushën specifike dhe çlirohen nga çdo presion dhe shtysë, sidomos financiare, që mund të ndikojë gjykimin e tyre ose rezultatet e veprimtarive të tyre të vlerësimit të konformitetit, sidomos në lidhje me personat ose grupet e personave që kanë interes në rezultatet e këtyre veprimtarive.

6. Organi i vlerësimit të konformitetit është i aftë të kryejë të gjitha detyrat e vlerësimit të konformitetit që i caktohen nga shtojca III dhe në lidhje me të cilat është miratuar.

Gjithmonë dhe për çdo procedurë të vlerësimit të konformitetit dhe çdo lloj ose kategori të aparateve në lidhje me të cilat është miratuar, organi i vlerësimit të konformitetit duhet të ketë në dispozicion:

a) stafin e nevojshëm me njohuri teknike dhe përvojë të mjaftueshme dhe të duhur për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit;

b) përshkrimet e procedurave në përputhje me të cilat është kryer vlerësimi i konformitetit, duke siguruar transparencën dhe aftësinë e riprodhimit të këtyre procedurave. Ai duhet të ketë të përcaktuara politika dhe procedura të duhura që dallojnë ndërmjet detyrave që kryen si organ i miratuar dhe veprimtarive të tjera;

c) procedurat e nevojshme për kryerjen e veprimtarive që marrin parasysh madhësinë e një sipërmarrjeje, sektorin ku vepron, strukturën, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së aparatit në fjalë dhe masën ose natyrën seri të procesit të prodhimit.

gj) mbledh dhe analizon rregullisht informacion mbi dinamikat dhe tendencat e tregut të punës nëpërmjet strukturave të varësisë dhe studimeve specifike dhe e raporton në ministrinë përgjegjëse dhe/ose e shkëmben me institucionet e interesuara, publike apo private;

h) kryen hulumtime periodike në tregun e punës për mbledhjen e të dhënave për numrin e të punësuarve, për kushtet e punës, procesin e rekrutimit, mungesën e aftësive apo të nevojave për trajnim, sipas metodologjive kombëtare dhe ndërkombëtare, të testuara e të miratuara;

i) siguron mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore nga ofruesit publikë të AFP-së, si dhe kryen rregullisht gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së;

j) verifikon që funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi;

k) i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe AFP-në akte ligjore dhe nënligjore në fushën e programeve aktive të tregut të punës, si dhe në lidhje me administrimin e ofruesve publikë të AFP-së;

l) siguron dhe garanton dialogun social nëpërmjet funksionimit të partneriteteve me palët e treta, organizatat punëmarrëse dhe punëdhënëse, si dhe monitoron e siguron mbarëvajtjen e zyrave të pajtimit në çdo qark, sipas legjislacionit të punës në fuqi;

ll) siguron dhe garanton zbatimin e procesit e të procedurave në zbatim të legjislacionit për vullnetarizmin;

m) i propozon ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe zhvillimit të aftësive nevojat për ndryshime të kuadrit ligjor rregullator, sipas fushave të përgjegjësisë;

n) mban regjistrin me certifikatat përfundimtare dhe suplementet e certifikatave të lëshuara nga ofruesit e arsimit dhe formimit profesional;

nj) kryen studime periodike për tregun e punës apo të një pjese të tij, në nivel kombëtar dhe rajonal;

o) kryen studime për gjurmimin e të diplomuarve të arsimit dhe formimit profesional;

p) ushtron kompetenca të parashikuara nga ky vendim dhe nga legjislacioni në fuqi.

9. Drejtoritë rajonale kryejnë detyrat, si më poshtë vijon:

a) Përgatisin planin e punësueshmërisë, në bazë të analizës së tregut rajonal dhe vendor të punës;

b) zbatojnë programet aktive të tregut të punës, në nivel rajoni;

c) zbatojnë programe të mbështetjes me të ardhura nga papunësia;

ç) sigurojnë dhe shpërndajnë informacionin mbi tregun rajonal të punës;

d) bashkëpunojnë me institucione dhe organizma të tjerë, që zbatojnë programe të ndryshme punësimi apo mbrojtjeje sociale;

dh) organizojnë punën dhe monitorojnë zbatimin e detyrave nga zyrat vendore;

e) identifikojnë nevojat për burime njerëzore, financiare, infrastrukturore etj. dhe i përcjellin pranë drejtorisë qendrore.

ë) hartojnë projektbuxhetin e drejtorisë rajonale dhe e dërgojnë për miratim në AKPA;

f) zbatojnë programin financiar rajonal.

10. Zyrat vendore kryejnë detyrat, si më poshtë vijon:

a) ofrojnë shërbime të punësimit për punëdhënësit dhe punëkërkuesit, duke përfshirë informacion rreth tregut rajonal dhe vendor të punës, profilizim të punëkërkuesit dhe referim në shërbimin e caktuar në bazë të nevojave, shërbimin e këshillimit, shërbime ndërmjetësimi, shërbimi orientimi në karrierë, shërbime të specializuara për personat me aftësi të kufizuara;

b) çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi.

11. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe të nëpunësve në drejtorinë qendrore të AKPA-së rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë në drejtorinë qendrore të AKPA-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

12. Marrëdhëniet e punës, në nivel rajonal e vendor, si dhe ofruesit e arsimit e formimit profesional, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Rekrutimi i punonjësve bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, mbi bazën e rregullave të miratuara në rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të AKPA-së.

13. AKPA-ja ka stemën, logon dhe vulën zyrtare. Stema e drejtorisë qendrore ka shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e (emri i ministrisë përgjegjëse), Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive", në përputhje me përcaktimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

14. Drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe ofruesit e arsimit e formimit profesional kanë stemat, logot dhe vulat e tyre zyrtare. Stema e secilës drejtori rajonale, zyrë vendore dhe ofruesi të arsimit e formimit profesional ka shënimet "Republika e Shqipërisë, Ministria e (emri i ministrisë përgjegjëse), Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, drejtoria rajonale/zyra vendore/ofruesi i arsimit dhe formimit profesional (emri i qarkut/qytetit, ku ka selinë), në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave, për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

15. Vula e AKPA-së e drejtorive rajonale, e zyrave vendore dhe e ofruesve të arsimit e formimit profesional ka elementet dhe formën e përcaktuar e vendimin e Këshillit të Ministrave, për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. KËSHILLI KONSULTATIV PËR PUNËSIMIN DHE SEKRETARIATI TEKNIK

1. Këshilli Konsultativ për Punësimin kryen këshillime, merr vendime me konsensus dhe i bën rekomandimet përkatëse AKPA-së.

2. Këshilli Konsultativ për Punësimin, i cili ngrihet në zbatim të nenit 15, të ligjit nr. 15/2019, ka këto kompetenca:

a) diskuton çështjet që lidhen me shërbimet e punësimit dhe programet e nxitjes së punësimit;

b) nxit bashkëpunimin efektiv ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave sindikale për çështjet e nxitjes së punësimit;

c) këshillon lidhur me mënyrën e përdorimit të Fondit Social të Punësimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

3. Ministri, si kryetar i KKP-së, e kryeson vetë këshillin dhe, në mungesë të tij, mund të autorizojë shprehimisht zëvendësministrin për kryesimin e mbledhjeve të tij.

4. Kryetari i Këshillit:

a) thërret mbledhjet dhe i drejton ato;

b) cakton rendin e ditës, drejton diskutimet, bashkërendon punën.

5. Këshilli funksionon, si më poshtë vijon:

a) mblidhet mbi bazën e një kalendari, por jo më pak se një herë në katër muaj;

b) kryetari vendos për datën dhe kohën e mbledhjeve të radhës, përveç rasteve kur vetë Këshilli ka vendosur ndryshe;

c) çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtari, në mënyrë që të njihet me këto ndryshime;

ç) mbledhjet bëhen nëse në to janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të Këshillit.

6. Këshilli mund të propozojë:

a) hartimin dhe zbatimin e politikave, të strategjive dhe të programeve kombëtare për nxitjen e punësimit dhe uljen e papunësisë e përgatitjen e akteve nënligjore;

b) përmirësimin e sistemit të punësimit dhe të zhvillimit të aftësive në përputhje me zhvillimet e sektorëve të ekonomisë dhe interesat e tregut të punës;

c) standardet për vlerësimin e cilësisë së programeve të nxitjes së punësimit;

ç) zhvillimin e politikave dhe të programeve të veçanta, të kërkuara nga ministrat përgjegjës;

dh) bashkëpunimin me organet shtetërore dhe aktorët e interesuar, informimin e tyre dhe koordinimin e iniciativave të përbashkëta.

7. Funksionimi i Këshillit mbështetet nga sekretariati teknik, i cili përbëhet nga dy punonjës të AKPA-së.

8. Sekretariati teknik bashkërendon veprimtarinë e Këshillit dhe kryen këto detyra:

a) organizon mbledhjet e Këshillit dhe krijon kushtet e nevojshme për zhvillimin e tyre;

b) komunikon me kryetarin e radhës dhe me anëtarët e Këshillit në lidhje me rendin e ditës, datën, orën dhe vendin e mbledhjes së Këshillit;

c) shpërndan dokumentacionin e mbledhjes dhe informacione të tjera tek anëtarët e Këshillit;

ç) mban minutat e mbledhjeve të Këshillit;

d) arkivon dokumentacionin e mbledhjeve të Këshillit.

9. Mënyra e organizimit dhe përgatitja e dokumentacionit të mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Punës përcaktohen në rregulloren e brendshme të miratuar prej tij.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë që, brenda 1 (një) muaji hyrja në fuqi të këtij vendimi:

a) të fillojë procedurën për propozimin e strukturës dhe të organikës së drejtorisë qendrore dhe rajonale/vendore të AKPA-së;

b) të përgatisë strukturën dhe organikën e ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe t'i miratojë ato pas miratimit të strukturës dhe të organikës së drejtorisë qendrore e drejtorive rajonale;

c) të marrë masat dhe të kryejë veprimet e nevojshme për rishpërndarjen e mjediseve të punës ekzistuese të Shërbimit Kombëtar të Punësimit si dhe për fondet buxhetore të AKPA-së, për vitin 2019.

2. Brenda 3 (tre) muajve nga emërimi, drejtori i Përgjithshëm i AKPA-së duhet të hartojë rregulloren për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit.

3. Deri në fillimin e funksionimit të plotë të AKPA-së, sipas këtij vendimi, Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e ofruesve të AFP-së vazhdojnë funksionimin e tyre në përputhje me strukturat dhe organikat aktualisht në fuqi.

4. Të gjitha të drejtat, detyrimet, buxheti, si dhe dokumentacioni administrativ e financiar i Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe buxheti e dokumentacioni administrativ e financiar i menaxhimit të ofruesve publikë të AFP-së i transferohen AKPA-së, pas ngritjes së saj.

5. Për nëpunësit civilë të Drejtorisë së Përgjithshme së Shërbimit Kombëtar të Punësimit zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil, në rastin e mbylljes dhe të ristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë dhe punonjësit e tjerë të strukturave aktuale zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

6. Detajimi i numrit të punonjësve, i fondeve të buxhetit të miratuar dhe transferimi i aktiveve të qëndrueshme realizohen në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 20.6.2008, "Për menaxhimin e sistemi buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe udhëzimeve standarde të ministrit përgjegjës për financat.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

8. Vendimi nr. 42, datë 17.1.1998, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit", të ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 555, datë 31.7.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 286, DATË 21.5.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISA RREGULLA TË VEÇANTA PËR PUNËMARRËSIT E PËRKOHSHËM, TË CILËT PUNËSOHEN NGA AGJENCITË E PUNËSIMIT TË PËRKOHSHËM"[2]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së

[2] Direktiva e Këshillit e datës 25 qershor 1991, që plotëson masat për nxitjen e përmirësimeve në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtorëve me marrëdhënie pune të qëndrueshme ose marrëdhënie të përkohshme të punës (91/383 / EEC) (OJ L 206, 29.7.1991, f. 19).

Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 286, datë 21.5.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

"2.1 Agjencia e përkohshme e punësimit informon punëmarrësin me marrëdhënie punësimi të përkohshme përpara fillimit të marrëdhënieve të punës për rreziqet specifike në vendin e punës, si dhe mbi çdo kualifikim ose aftësi të posaçme profesionale ose mbikëqyrje të veçantë mjekësore, që kërkon vendi i punës.".

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"3. Ndërmarrja pritëse u siguron punëmarrësve të përkohshëm trajnimin e nevojshëm dhe në përputhje me karakteristikat e vendit të punës, njësoj si punëmarrësve të përhershëm, duke marrë parasysh kualifikimin dhe eksperiencën e tyre, me qëllim përmirësimin e aftësive dhe të njohurive të tyre për fushën e pozicionit ku janë punësuar.".

3. Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

"5.1 Punëmarrësit e punësuar nëpërmjet agjencive të përkohshme që bëjnë pjesë në grupet e rrezikuara, sipas legjislacionit në fuqi, mbrohen ndaj rreziqeve që i prekin ata në mënyrë të veçantë. Punëdhënësi siguron për këtë kategori punëmarrësish mbikëqyrje të veçantë mjekësore, sipas legjislacionit në fuqi.".

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore si dhe agjencitë e punësimit të përkohshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 556, datë 31.7.2019

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA KËSHILLI I MINISTRAVE TE MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, TË PASURISË ME EMËRTIMIN "GODINË RESTORANT DY KATE, STABILIMENT DURRËS", DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1058, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Këshilli i Ministrave te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të pasurisë "Godinë restorant dy kate, stabiliment Durrës", në përdorim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1058, datë 16.7.2008, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Këshillit të Ministrave, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare".

3. Ngarkohen Kryeministria, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr.557, datë 31.7.2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.651, DATË 10.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR.102/2014, "KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 10, 18, 19, 24, 26, 29, 35, 39 deri 42, 47, 51, 58, 62, 64, 71, 83, 94, 98, 100, 108, 115, 118, 119, pika 7, 123, 129, 133, 141, 145, 148, 149 deri 152, 153, pikat 1, 2 e 3, 154, 160 deri 169, 174 deri 177, 181, 184, 188, 190, 193, 196, 200, 202, 206, 209, 212, 216, 226, 238, 240, 245, 248, 284, 286, 287 dhe 288, të ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në titullin I, kreu 1, pas pikës 66, të nenit 1, shtohet pika 67, me këtë përmbajtje:

"67. "Zonë e lirë doganore", është një pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë që i nënshtrohet legjislacionit doganor, në të cilën lejohet të kryhet çdo aktivitet industrial, tregtar ose shërbimi.".

2. Në titullin VII, pas seksionit 2, të kreut 3, shtohen seksionet 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

"Seksioni 3
Zonat e lira doganore

Neni 648-1
Kushtet e përgjithshme të funksionimit
(Nenet 28, 84, 192, pika 1 dhe 216, të Kodit)

1. Në përputhje me dispozitat e këtij seksioni, dispozitat lidhur me regjimin e magazinimit doganor, të referuara në këtë vendim, zbatohen edhe për qëllime të këtij seksioni.

2. Çdo person juridik, i vendosur në Republikën e Shqipërisë, mund të aplikojë për veprimtari në një zonë të lirë doganore, me kusht që të përmbushë kushtet si dhe detyrimet e përcaktuara në këtë vendim dhe në legjislacionin në fuqi.

3. Autorizimi për veprimtari në zonë të lirë doganore miratohet pas plotësimit të kushteve dhe kritereve të mëposhtme:

a) Përdorimi nga aplikuesi i sistemeve kompjuterike të përpunimit të të dhënave për paraqitjen e deklarimeve dhe njoftimeve doganore elektronike, në sistemin informatik të doganës apo në sisteme specifike të krijuara për këtë qëllim, duke zbatuar dispozitat përkatëse lidhur me këto teknika apo sisteme;

b) Përdorimi i sistemeve të monitorimit me videokamera dhe i ndriçimit. Aplikuesi, për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli nga autoritetet doganore është i detyruar që më shpenzimet e tij të bëjë ndriçimin e ambienteve dhe rrethimit, si dhe instalimin, vendosjen, mirëmbajtjen, furnizimin me energji të pandërprerë etj., të sistemeve mbikëqyrëse me videokamera dhe të sigurojë transmetimin on-line dhe ruajtjen e pacenuar të imazheve të regjistruara nga sistemet mbikëqyrëse me videokamera. Sistemi i ndriçimit dhe i videokamerave duhet të mundësojë kontrollin e perimetrit të jashtëm të zonës së lirë doganore, si dhe ambientet e brendshme të tyre. Aplikuesi siguron të gjitha pajisjet e nevojshme për autoritetet doganore, shikueshmërinë on-line të imazheve dhe ruajtjen e imazheve për një periudhë të paktën prej 3 (tre) muajsh. Në rast se ka filluar procedura hetimore/gjyqësore, këto imazhe ruhen deri në përfundim të procesit hetimor dhe/ose gjyqësor. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përcakton vendet dhe këndet e pozicionimit të kamerave në këto ambiente;

c) Vendosja në dispozicion të autoriteteve doganore të ambienteve të punës, të cilat duhet të plotësojnë standardet e përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

ç) Rrethimi i zonës së lirë doganore, së paku me gardh metalik të qëndrueshëm me bazament solid, në një lartësi jo më pak se 2 (dy) metra;

d) Shoqëria (aplikuesi), administratori, anëtarët e bordit apo këshillit drejtues dhe punonjësi përgjegjës në shoqërinë aplikuese për

çështjet doganore, nuk kanë detyrime doganore të papaguara dhe nuk kanë kryer shkelje penale në fushën doganore dhe të akcizës për një periudhë 5 (pesë)-vjeçare nga data e aplikimit.

4. Pas miratimit, mbajtësi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore, duhet të përmbushë në vazhdimësi kushtet dhe kriteret e përcaktuara, pa cenuar detyrimet dhe rregullat për lindjen e një borxhi doganor.

5. Mbajtësi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore duhet të përmbushë të gjitha kushtet dhe rregullat e përcaktuara në autorizim në lidhje me kontrollin doganor, çlirimin e mallrave, regjistrat e magazinimit të mallrave dhe dispozita të tjera relevante. Në rast se nuk përmbushen të gjitha këto kushte, kjo gjë sjell shfuqizimin apo anulimin e autorizimit dhe për të gjitha mallrat e ruajtura në këtë zonë duhet t'u caktohet menjëherë një destinacion doganor. Në rast se mbajtësi i autorizimit nuk i jep destinacion doganor mallrave, zyra doganore mbikëqyrëse vijon me masat e përcaktuara në kreun IV, të titullit V, të Kodit Doganor.

6. Mbajtësi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore duhet të informojë Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për të gjithë faktorët e dalë pas miratimit, të cilët mund të ndikojnë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij.

7. Mbajtësi i autorizimit, për veprimtari në zonë të lirë doganore, duhet të plotësojë të gjitha kushtet e punës për autoritetet doganore, pa asnjë shpenzim nga këto të fundit.

Neni 648-2
Aplikimi për veprimtari në zonë të lirë doganore
(Pika 1, e nenit 27, të Kodit)

1. Aplikimi për veprimtari në zonë të lirë doganore paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

2. Aplikimi bëhet me shkrim, sipas aneksit 14, të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Aplikimi duhet të shoqërohet me dokumentet e mëposhtme (në formë shkresore dhe elektronike CD, së bashku me materiale fotografike ose filmike):

a) Gjendjen financiare të shoqërisë tregtare dhe statusin e saj, i cili duhet të jetë aktiv;

b) Aktin e disponimit për ambientin/godinën që do të përdoret për këtë qëllim;

c) Vërtetimin, që nuk është dënuar penalisht për vepra penale që lidhen me aktivitetin ekonomik të aplikuesit, ndonjë nga personat e mëposhtëm:

i) Aplikuesi;

ii) Administratori;

iii) Anëtarët e bordit apo këshillit drejtues;

iv) Punonjësi përgjegjës në shoqërinë aplikuese për çështjet doganore.

ç) Planin e organizimit të punës dhe listën e personelit kyç që do të operojë në zonën e lirë doganore dhe që do të ndjekë zbatimin e këtij plani. Listës duhet t'i bashkëlidhet kopje e letërnjoftimeve të personelit;

d) Detyrimin për të siguruar mundësinë për mbyllje me dryn ose plumbosje nga autoritetet doganoretë ambienteve, godinave, instalimeve etj;

dh) Kushtet e ruajtjes dhe të sigurisë së mallrave në këto mjedise, mundësinë e mbikëqyrjes nga autoriteti doganor dhe zyra/ambienti që i ofrohet këtij të fundit;

e) Prezantimin e sistemit dhe të aparaturave matëse, që mundësojnë verifikimin fizik të sasisë gjendje, në çdo moment që do të kërkohet nga autoritetet doganore, si edhe ndarjen e mallrave sipas statusit të tyre;

ë) Listën e mjeteve që disponon operatori për plotësimin e nevojave të ushtrimit të aktivitetit dhe që lidhen me trajtimet, përpunimet, matjet, transportin, kontrollin, ruajtjen dhe sigurinë;

f) Lejen, licencën, aktin e kolaudimit apo të kalibrimit, lejen mjedisore dhe dokumente të tjera që vërtetojnë plotësimin e kushtëzimeve të përcaktuara në këtë vendim dhe në legjislacionin në fuqi që rregullon fusha të veçanta e që mbulojnë aktivitetin e kërkuar.

4. Aplikimi duhet t'i referohet dokumenteve shoqëruese, të cilat duhet të jenë origjinale apo kopje të noterizuara të origjinalit, si prova mbështetëse apo dokumente që kanë lidhje me hollësitë e dhëna në aplikim, paraqitja e të cilave nevojitet për vlerësimin e aplikimit dhe të plotësimit të kushteve e të kritereve.

5. Aplikimi mund të shoqërohet nga dokumente shtesë, në të cilat jepet informacion

provues mbi plotësimin e kushteve dhe të kërkesave të përcaktuara në këtë vendim. Të gjitha këto dokumente, prova apo fletë shtesë konsiderohen pjesë përbërëse të aplikimit që ato shoqërojnë. Në aplikim shënohet edhe numri i anekseve.

Neni 648-3
Procedurat përpara miratimit të autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore
(Neni 27, pika 1, dhe 217, të Kodit)

1. Me marrjen e aplikimit, strukturat në DPD, në bashkëpunim me degën doganore mbikëqyrëse, verifikojnë informacionin e paraqitur. Kur konstatohet se aplikimi nuk përmban të gjitha të dhënat/dokumentet/informacionet e kërkuara, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së aplikimit i kërkohet aplikuesit (operatorit ekonomik) të plotësojë të dhënat/dokumentet/informacionet e duhura, duke i dhënë edhe arsyet e kësaj kërkese. Personi i interesuar duhet të plotësojë informacionin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kësaj kërkese, në të kundërt aplikimi konsiderohet i refuzuar dhe personi i interesuar mund të aplikojë si për herë të parë.

2. Dega doganore mbikëqyrëse, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e konstatimit se plotësohen të gjitha kushtet dhe dokumentacioni/informacionet e sipërpërmendura, procedon me:

a) verifikimin nëse dokumentacioni i paraqitur përputhet me gjendjen reale si dhe me këqyrjen në vend të vendndodhjes/ambienteve për të cilat kërkohet zona e lirë;

b) kushtet e ruajtjes së sigurisë së mallrave në këto ambiente, numrin e dyerve dhe mundësinë e mbylljes me dryn, plumbosjes, mbylljen e dritareve etj.;

c) mundësinë e monitorimit, të mbikëqyrjes, të kontrollit, të ndarjes, të inventarizimit të mallrave etj., nga autoritetet doganore;

ç) verifikimin e vërtetësisë (kur gjykohet e arsyeshme) të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesi.

3. Kur konstatohen mosvërtetësi të dokumentacionit të paraqitur, aplikimi refuzohet dhe strukturat doganore duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e përcaktuar në legjislacionin në fuqi, përfshirë këtu edhe kallëzimin penal, kur është rasti.

4. Kur konstatohen parregullsi, i kërkohet aplikuesit që të plotësojë apo të rregullojë situatën duke marrë masat e duhura brenda një periudhe kohore prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Në varësi të rrethanave dhe të specifikave të ambientit për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli, mund të kërkohet dokumentacion shtesë apo të vendosen kushte të tjera përtej atyre të përcaktuara në këtë vendim.

5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i procesit të verifikimit apo nga rregullimi i situatës, dega doganore mbikëqyrëse përcjell në DPD një relacion, ku sqarohet në mënyrë të detajuar e gjithë procedura e ndjekur deri në këtë moment, si edhe përfundimi i verifikimeve të kryera.

Neni 648-4
Miratimi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore
(Neni 217 i Kodit)

1. Kur DPD-ja konstaton se aplikimi është i rregullt dhe në përputhje me kushtet dhe kërkesat e këtij vendimi dhe me legjislacionin doganor në fuqi, si edhe konkludohet mbi mundësinë për mbikëqyrje e kontroll, miraton autorizimin për veprimtari në zonë të lirë doganore, sipas aneksit 15, të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në përputhje me përcaktimet e nenit 648-11, kryen aktivizimin në sistemin kompjuterik të fillimit të regjimit të zonës së lirë doganore.

Neni 648-5
Përgjegjësitë e mbajtësit të autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore
(Nenet 28 dhe 217, të Kodit)

Mbajtësi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore ka përgjegjësi:

a) për mallrat e magazinuara në ambientet e autorizuara;

b) për të siguruar që mallrat nën regjimin e zonë së lirë doganor të mos nxirren/të dalin nga mbikëqyrja doganore;

c) për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga magazinimi i mallrave të mbuluara nga regjimi i zonës së lirë doganore;

ç) për të marrë aprovimin paraprak nga DPD-ja për çdo ndryshim strukturor në ambientet e autorizuara;

d) për të marrë masat për sigurinë e mjediseve të zonës së lirë doganore;

dh) për të siguruar që hyrja/dalja në dhe nga zona e lirë doganore të jetë e sigurt;

e) për zbatimin korrekt të legjislacionit shqiptar në fuqi e në veçanti të legjislacionit doganor lidhur me regjimin e zonës së lirë doganore dhe/ose regjime apo procedura të tjera të nevojshme sipas rastit, si dhe për të zbatuar rregullat e kushtet e tjera të vendosura prej autoriteteve doganore për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli;

ë) për të mirëmbajtur dhe përditësuar të dhënat e inventarit dhe vënien e tyre në dispozicion të autoriteteve doganore sa herë që kërkohen për qëllime mbikëqyrjeje dhe kontrolli;

f) për të informuar zyrtarisht me shkrim dhe pa vonesë zyrën doganore mbikëqyrëse, nëse konstaton mospërputhje mes stokut faktik në zonën e lirë doganore dhe stokut sipas sistemit elektronik doganor.

Neni 648-6
Pezullimi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore
(Nenet 28 dhe 217, të Kodit)

1. Autorizimi për veprimtari në zonë të lirë doganore pezullohet nga DPD-ja kur:

a) nga autoritetet doganore konstatohen mospërputhje me përcaktimet e neneve 648-1 deri 648-3;

b) autoriteti doganor ka arsye të mjaftueshme të besojë që një veprim, i cili mund të shkaktojë procedim penal lidhur me shkelje të legjislacionit doganor, akcizës apo atë tatimor, është kryer nga mbajtësi i autorizimit, anëtarët e bordit apo këshillit drejtues, aksionerët e shoqërisë në rast se operatori ekonomik aplikues është një shoqëri aksionare apo personi përgjegjës në shoqërinë aplikuese për çështjet doganore.

2.Para marrjes së vendimit, DPD-ja ia komunikon konstatimet mbajtësit të autorizimit për zonë të lirë doganore. Mbajtësi i autorizimit, për zonë të lirë doganore, ka të drejtë të korrigjojë situatën dhe/ose të shprehë qëndrimin e tij brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e komunikimit.

3.Nëse mbajtësi i autorizimit nuk e rregullon situatën e përmendur në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, DPD-ja njofton mbajtësin e autorizimit për zonën e lirë doganore mbi pezullimin për një periudhë kohore prej 30 (tridhjetë) ditësh, duke i mundësuar atij marrjen e masave të kërkuara për të rregulluar situatën.

4.Në rastet e referuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, DPD-ja pezullon autorizimin deri në fund të procedimit në gjykatë. DPD-ja njofton mbajtësin e autorizimit për këtë qëllim.

5. Kur mbajtësi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore nuk është në gjendje të rregullojë situatën brenda 30 (tridhjetë) ditëve, por mund të japë prova që kushtet mund të përmbushen nëse shtyhet periudha e pezullimit, DPD-ja pezullon autorizimin për një periudhë tjetër prej 30 (tridhjetë) ditësh kalendarike. Për këtë qëllim njoftohet mbajtësi i autorizimit.

6.Gjatë periudhës së pezullimit të autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore, ambientet, godinat, si dhe instalimet respektive mbyllen me dryn/plumbosje nga zyra doganore mbikëqyrëse. Vetëm nën mbikëqyrjen e zyrës doganore mbikëqyrëse këto ambiente mund të hapen dhe mbajtësi i autorizimit mund të kryejë vetëm veprime që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e pajisjeve apo mallrave si dhe t'u japë destinacion tjetër mallrave që janë në prag të skadencës.

Neni 648-7
Heqja e pezullimit të autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore
(Nenet 28 dhe 217, të Kodit)

1. Kur mbajtësi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore vlerësohet se ka marrë masat e nevojshme për të plotësuar kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen, DPD-ja heq pezullimin dhe informon mbajtësin e autorizimit.

Pezullimi mund të hiqet përpara përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikat 4 ose 6, të nenit 648-6.

2. Nëse mbajtësi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore dështon të marrë masat e nevojshme brenda periudhës kohore të pezullimit të parashikuar në pikën 4 ose 6, të nenit 648-6, atëherë zbatohet neni 648-9.

Neni 648-8
Pezullimi me kërkesë i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore
(Neni 28 i Kodit)

1. Kur mbajtësi i një autorizimi për veprimtari në zonë të lirë doganore nuk është në gjendje të përmbushë përkohësisht ndonjë nga kushtet dhe kriteret e përcaktuara, ai mund të kërkojë pezullimin e tij. Në raste të tilla, mbajtësi i autorizimit njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, duke specifikuar datën kur ai do të jetë në gjendje të përmbushë kushtet dhe kriteret përsëri. Ai, gjithashtu, njofton për masat e planifikuara dhe afatet kohore për përmbushjen e tyre. Edhe në këtë rast aplikohen masat e përcaktuara në nenin 648-6.

2. Nëse mbajtësi i një autorizimi për zonë të lirë doganore dështon të rregullojë situatën brenda periudhës kohore të përcaktuar në njoftimin e tij, DPD-ja mund të autorizojë një shtyrje të arsyeshme, me kusht që mbajtësi i autorizimit të ketë vepruar me vullnet të mirë.

Neni 648-9
Shfuqizimi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore
(Neni 217 i Kodit)

Me propozim të degës doganore mbikëqyrëse të zonës së lirë doganore, DPD-ja shfuqizon autorizimin për veprimtari në zonë të lirë doganore në rastet e mëposhtme:

a) Kur mbajtësi i autorizimit dështon të rregullojë situatën e referuar në pikën 4, të nenit 648-6 dhe në pikën 1, të nenit 648-8;

b) Kur janë identifikuar në mënyrë të përsëritur raste kundërvajtjeje në plotësimin e kushteve për hyrje-daljen e mallrave dhe regjistrimin e tyre;

c) Kur janë kryer shkelje të rënda ose të përsëritura në lidhje me legjislacionin doganor, akcizën apo atë tatimor nga mbajtësi i autorizimit ose personat e tjerë të përcaktuar në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 648-6, dhe kur ka shteruar e drejta e ankimimit;

ç) Falimentimi i mbajtësit të autorizimit sipas vendimit gjyqësor;

d) Me kërkesë të mbajtësit të autorizimit.

Neni 648-10
Anulimi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore
(Neni 217 i Kodit)

1. Me propozim të degës doganore mbikëqyrëse të zonës së lirë doganore, DPD-ja anulon një autorizim për veprimtari në zonë të lirë doganore, në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Autorizimi është dhënë bazuar në informacion të rremë, të pasaktë ose të falsifikuar;

b) Personi, ndaj të cilit është dhënë vendimi, ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni që informacioni i dhënë ishte i rremë, i pasaktë ose i falsifikuar.

2. Anulimi i shtrin efektet që nga data e hyrjes në fuqi të vendimit fillestar, përveçse kur, në përputhje me legjislacionin doganor, në vendim specifikohet ndryshe.

Neni 648-11
Rakordime dhe kontrolle
(Neni 218, 219, 220, 221 dhe 222, të Kodit)

1. Pas miratimit të zonës së lirë doganore, DPD-ja miraton:

a) rregulloren për funksionimin e zonës së lirë doganore. Rregullorja përmban organizimin e zonës, sigurinë e ndërtesave dhe objekteve, sigurinë dhe kushtet e punës, lejet dhe dokumentet e hyrjes së personave në zonë, etj.;

b) regjistrat e paraqitur nga aplikuesi për veprimtari në zonë të lirë doganore.

2. Gjatë ushtrimit të aktivitetit, mbajtësi i autorizimit është i detyruar të regjistrojë dhe të dokumentojë të gjitha hyrjet/daljet e mallrave në zonën e lirë doganore si dhe të paraqesë pranë autoriteteve doganore të zyrës mbikëqyrëse për

çdo rast, sipas legjislacionit në fuqi, deklarimet të shoqëruara me dokumentet përkatëse.

3. Brenda datës 5 (pesë) dhjetor të çdo viti, mbajtësi i autorizimit për veprimtari në zonë të lirë doganore, dorëzon pranë autoriteteve doganore të zyrës mbikëqyrëse, raport për gjendjen e mallrave.

4. Të gjitha veprimet për hyrjen/daljen e mjeteve dhe të mallrave në dhe nga zona e lirë doganore janë objekt i njoftimit dhe lejes përkatëse të autoriteteve doganore të zyrës mbikëqyrëse.

Këto veprime mund të kryhen vetëm gjatë orarit të përcaktuar nga autoritetet doganore.

Seksioni 4
Krijimi i zonës së lirë doganore
Neni 648-12

Ministria përgjegjëse për financat i paraqet Këshillit të Ministrave propozimin për krijimin e zonës së lirë doganore, në përputhje me nenin 216, të ligjit nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 648-13
Dokumentet tip që i bashkëlidhen propozimit për krijimin dhe shtrirjen territoriale të zonës së lirë doganore

Propozimit për krijimin dhe shtrirjen territoriale të zonës së lirë doganore i bashkëlidhet dokumentacioni që përbëhet nga:

a) Kërkesa e subjektit, e shoqëruar me informacion në lidhje me aktivitetin e shoqërisë.

b) Planvendosja e territorit që propozohet për krijimin e zonës së lirë doganore, e hartuar nga ekspertë të licencuar, ku të jenë përcaktuar pikat e hyrjes dhe të daljes.

c) Në rastin kur zona e lirë doganore do të krijohet në pasurinë në pronësi të subjektit kërkues, nga ana e tij duhet të dorëzohet përshkrimi i pronës private, vendndodhja e saj, dokumenti i pronësisë, statusi juridik aktual i pasurisë i lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e shoqëruar me hartën treguese të pasurisë.

ç) Në rastin kur zona e lirë doganore do të krijohet në pasuri, jo në pronësi të subjektit kërkues, ky i fundit së bashku me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3, duhet të dorëzojë edhe aktmarrëveshjen paraprake, të lidhur ndërmjet subjektit dhe pronarit të pasurisë.

d) Mendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.".

3. Në shtojcën A, pas aneksit 13, shtohen aneksi 14, "Aplikimi për zonë të lirë doganore" dhe aneksi 15, "Autorizim për administrimin e një zone të lirë Doganore", që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 14

APLIKIMI PËR ZONË TË LIRË DOGANORE

1. Aplikuesi, Numri i Identifikimit, Informacionet e kontaktit:
……
……
……

……
……
……

……
……
……

2. Vendndodhja, objektet, harta e instalimeve që synohet të përdoren në zonën e lirë doganore:
……
……
……

……
……
……

……
……
……

3. Autorizimi/et e dhëna për regjime të posaçme doganore:
……
……
……

……
……
……

4. Procedurat për:
a) futjen e mallrave:
……
……

……
b) vendosjen në qarkullim të lirë të mallrave të futura:
……
……
……

c) rieksportimin e mallrave të futura:
……
……
……

5. Përcaktimi i nevojës për përdorimin e zonës së lirë doganore:
……
……
……

6. Përshkrimi i regjistrave/inventarit të stokut të mbajtura ose që planifikohen dhe vendi ku ato mbahen ose do të mbahen:
……
……
……

7. Periudha mesatare e magazinimit:
……
……
……

8. Lloji i mallrave:
……
……
……

……
……
……

……
……
……

……
……
……

9. Zyra doganore mbikëqyrëse:
……
……

10. Deklaratë noteriale e aplikuesit që nuk do të përdorë hyrje/daljetubacione apo instalime të tjera për hyrje/dalje mallrash apo njerëzish përveç atyre të miratuara:

……
……
……

……..……
……
……..……

……..……
……
……..……

……..……
……
……..……

11. Lista e dokumenteve shoqëruese bashkëngjitur:
……..……
……
……..……

……..……
……
……..……

……..……
……
……..……

……..……
……
……..……

Data: …….

Emri, Mbiemri, Firma, Vula:
……

SHËNIME SHPJEGUESE PËR ANEKSIN 14 (APLIKIMIN PËR TË PËRFITUAR AUTORIZIM PËR ZONË TË LIRË DOGANORE)

1. Shkruani emrin, adresën e plotë të aplikuesit dhe numrin e identifikimit. Aplikuesi është personi të cilit mundet t'i lëshohet autorizimi. Shkruani informacionin e duhur të kontaktit (personin e kontaktit, adresën e kontaktit, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e-mail)

2. Përcaktoni vendndodhjen, objektet, instalimet që synohen të përdoren në zonën e lirë doganore dhe parashikimin se si godina / ambienti/instalimet janë projektuar për të funksionuar.

3. Shkruani tipin, referencën dhe nëse zbatohet, datën e mbarimit të autorizim-it/eve përkatës për përdorimin e regjimeve të posaçme doganore.Në rastet kur sapo është aplikuar për autorizim, shkruani llojin e autorizimit për të cilin aplikohet dhe datën e aplikimit.

Kodi	Regjimi i Autorizuar
1	Magazinë Doganore
2	Përpunim aktiv
3	Përpunim pasiv
4	Lejim i përkohshëm
5	Përdorim i veçantë përfundimtar (*end use*)

4. Përcaktoni në mënyrën e përshtatshme:

a) regjimin normal për futjen e mallrave,

b) regjimin normal për vendosjen në qarkullim të lirë të mallrave të futura,

c) regjimin normal për rieksportimin e mallrave të futura.

5. Përcaktoni në mënyrë të qartë nevojat për përdorimin e zonës së lirë doganore.

6. Përshkruani qartë regjistrat e mbajtura ose që planifikohen të mbahen dhe vendi ku ato mbahen ose do të mbahen. Regjistrat duhet të përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme që mundësojne mbikëqyrjen dhe kontrollin doganor.

7. Përcaktoni qartë periudhën mesatare të magazinimit të mallrave.

8. Përshkruani në mënyrën e përshtatshme dhe sipas kodeve tarifore:

a) mallrat jo shqiptare,

b) mallrat jo shqiptare me akcizë,

c) mallrat shqiptare ekuivalente,

d) mallrat shqiptare ekuivalente me akcizë,

ç) mallrat shqiptare me akcizë apo jo.

9. Vendosni emërtimin e zyrës doganore mbikëqyrëse.

10. Deklarata noteriale duhet të japë qartë vullnetin e aplikuesit se nuk do të përdorë asnjë portë hyrje/dalje, tubacion apo instalime të tjera për hyrje/dalje mallrash apo njerëzish përveç atyre të miratuara për zonën e lirë doganore për të cilën po aplikohet.

11.Vendosni në mënyrë të qartë listën e të gjithë dokumentave të cilat shoqërojnë aplikimin.

Të dhënat jo-konfidenciale të aksesueshme për publikun e gjerë:

Publikut të gjerë do ti jepet akses në të dhënat e mëposhtme (duke iu referuar formularit të aplikimit):

- Numri i autorizimit të dhënë;
- Kodi i zyrës doganore mbikëqyrëse;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË *.ANEKSI 15*

<table>
<tr><td>1.Mbajtësi:

Numri identifikues:</td><td colspan="2">AUTORIZIM PËR ADMINISTRIMIN E NJË ZONE TË LIRË DOGANORE

Nr: _____</td></tr>
<tr><td colspan="2">2. Aplikimi: nr._____, datë _____</td><td>3. Zyra Mbikëqyrëse: Dega e Doganës _____</td></tr>
<tr><td>4. Ambientet e Zonës së Lirë Doganore:</td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="2">5. Orari i veprimeve:</td><td>6. Data e hyrjes në fuqi:</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">7. Operacione të zbatueshëm :

në hyrje:

në dalje:</td><td>8. Porta e hyrjes:</td></tr>
<tr><td>9. Porta e daljes:</td></tr>
<tr><td colspan="2">10. Mallrat që mund të pranohen:</td><td>11. Shkalla humbje/firo:</td></tr>
<tr><td colspan="3">12. Mallra të tjerë:</td></tr>
<tr><td colspan="3">13. Format e zakonshme të përpunimit:</td></tr>
<tr><td colspan="3">14. Mënyra e dokumentimit të veprimeve operacionale:</td></tr>
<tr><td colspan="3">15. Përdorimi i regjimeve doganore ekonomike:</td></tr>
<tr><td colspan="3">16. Dispozitat ligjore të detyrueshme për zbatim:</td></tr>
<tr><td colspan="2">17. Shënime:</td><td></td></tr>
<tr><td>19. Autoriteti që miraton: DPD

Vendi:

Data: ___/___/___</td><td colspan="2">18. Shtojca:</td></tr>
</table>

VENDIM
Nr. 558, datë 31.7.2019

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITI 2019, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e vitit 2019, në zërin "Shpenzime korente", i shtohet fondi prej 22 494 048 (njëzet e dy milionë e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyzet e tetë) lekësh për fillimin e organizimit të edicionit të 41-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë, që do të zhvillohet në datat 21–24 tetor 2019, në Tiranë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 559, datë 31.7.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit, numri maksimal i pagesave në një vit, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera, për "Këshillin miratues të projekteve të filmit artistik", bëhet 6 (gjashtë).

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr.560, datë 31.7.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.768, DATË 12.11.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VENDDEPOZITIMIT SANITAR TË MBETJEVE NË AFËRSI TË MALIQIT DHE RRUGËS HYRËSE, QARKU KORÇË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr.99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.768, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Tabelës bashkëlidhur vendimit i shtohet lista sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Në pikën 3 të vendimit, sipërfaqja ndryshohet, nga 149 596 (njëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) m^2, në 150 469 (njëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) m^2.

c) Në pikat 3 dhe 4 të vendimit, vlera e përgjithshme e shpronësimit të pronarëve ndryshohet, nga 36 021 456 (tridhjetë e gjashtë milionë e njëzet e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë, në 36 206 532 (tridhjetë e gjashtë milionë e dyqind e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë.

2. Vlera prej 185 076 (njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh do të përballohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin buxhetor "Menaxhim i mbetjeve urbane", për vitin 2019.

3. Shpenzimet procedurale, me vlerë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

5. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria aksionare "Administrimi i mbetjeve të Qarkut Korçë, KRWM", Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-NË NR. 768, DATË 12.11.2014 "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I VENDDEPOZITIMIT SANITAR TË MBETJEVE NË AFËRSI TË MALIQIT DHE RRUGËS HYRËSE", QARKU KORÇË

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale m^2	Sipërfaqja e prekur nga shpronësimi m^2	Tokë arë Çmimi lekë/m^2	Vlera totale	Shënime
1	Lirije	Nexhat	Tili	1667	20/73	arë	873	873	212	185,076	Konfirmuar nga ZRPP, më datë 15.12.2015
Vlera totale										**185,076**	

Shënim ***1.*** *Për vlerësimin e pasurisë të llojit "tokë arë", çmimi për njësi i është referuar çmimit të vendosur në VKM nr. 768, date 12.11.2014*

VENDIM
Nr.561, datë 31.7.2019

PËR DHËNIEN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE "PETER MAHRINGER", SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2019 – 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 39 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9522, datë 25.4.2006, "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të 84 (tetëdhjetë e katër) bursave të studimit për nxënësit e shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", Shkodër, nga të cilat 24 (njëzet e katër) bursa studimi për nxënësit e viteve përgatitore dhe 60 (gjashtëdhjetë) bursa studimi për nxënësit nga viti i parë deri në vitin e katërt të shkollës së mesme profesionale "Peter Mahringer", për vitin shkollor 2019-2020.

2. Vlera vjetore e bursës do të jetë 92 820 (nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzet) lekë për nxënës, me qëllim shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe për mbulimin e kostos së teksteve mësimore. Vlera e masës së bursës do të paguhet pranë bankave të nivelit të dytë për çdo nxënës/prind/përfaqësues ligjor të nxënësve përfitues.

3. Fondi për mbulimin e këtyre bursave kalon nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, në mbështetje të kritereve ekonomike, si dhe të rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i Fondacionit Shkollor Austriak, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, Shkodër, i cili, pas konfirmimit të nxënësve që përfitojnë bursë, kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, pa efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 562, datë 31.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË BORDIT TË AKREDITIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Shkronja "b", e pikës 27, ndryshohet si më poshtë vijon:

"b) Anëtarët e huaj, në masën 600 (gjashtëqind) euro;".

b) Pika 28 ndryshohet si më poshtë vijon:

"28. Kryetarit dhe anëtarëve, të huaj e shqiptarë, të Bordit të Akreditimit, me rezidencë të

përhershme jashtë Shqipërisë, iu mbulohen shpenzimet e udhëtimit e të akomodimit në Shqipëri, për jo më shumë se tri ditë kalendarike për mbledhje.".

c) Pika 6, e shtojcës 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

"6. Eksperti vendas ose i huaj, që angazhohet në kuadër të plotësimit të kushteve apo për vlerësimin paraprak në kuadër të hapjes dhe/ose riorganizimit të IAL-ve, dhe të programeve të studimit, përzgjidhet nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e miratuar nga ASCAL-i. Numri i ekspertëve duhet të jetë jo më pak se dy dhe masa e pagesës për të gjithë ekspertët të jetë jo më shumë se 25% e tarifës bazë të parashikuar për vlerësimin e jashtëm të IAL-së dhe/ose programit të studimit, sipas tabelave 2/a dhe 2/b.".

ç) Në fund të pikës 2, të shtojcës 2, shtohen fjalitë, si më poshtë vijon:

"Vlerësimi i jashtëm në kuadër të akreditimit të parë të programeve profesionale të studimit, si dhe të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë në IAL-të publike bëhet i grupuar, aty ku është e mundur dhe për jo më shumë se tri programe, sipas ciklit dhe fushës së studimit në nivel njësie bazë. Tarifat për vlerësimin në kuadër të akreditimit të parë të këtyre programeve të jenë sa 65% e tarifës së secilit program që do të vlerësohet i grupuar, sipas tabelës 2/b.

Në rastet kur njësia bazë ofron një program studimi profesional apo nga një program studimi për ciklin e parë dhe/ose të dytë, tarifat për vlerësimin në kuadër të akreditimit të parë të këtyre programeve të jenë sa 65% e tarifës së programit përkatës, sipas tabelës 2/b.

Ekspertët për vlerësimin e jashtëm, në kuadër të akreditimit të parë të programeve të studimit profesional, si dhe të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimit në IAL-të publike, paguhen 70% të vlerës së secilit program studimi që vlerësohet i grupuar sipas tabelës 1/b.".

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 563, datë 31.7.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 107, DATË 10.2.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR BOTIMIN, SHTYPJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 47, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 6.12, e vendimit nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"6.12. Nxënësve që ndjekin arsimin fillor në klasën e parë në institucionet arsimore publike u jepen tekstet shkollore të reja, çdo vit, në përdorim falas. Nxënësve, që ndjekin arsimin fillor në institucionet arsimore publike nga klasa e dytë deri në klasën e pestë, u jepen tekstet shkollore në përdorim falas. Çmimi i blerjes së teksteve shkollore mbulohet 100% nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin. Institucionet arsimore publike, si dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, brenda muajit korrik të çdo viti, përgatisin listën e parashikuar të teksteve për përdorim falas dhe të reja, nga klasa e parë deri në klasën e pestë.

Blerja e teksteve të reja shkollore të nxënësve që ndjekin arsimin fillor nga klasa e parë deri në klasën e pestë në institucionet arsimore publike, në emër të prindërve ose të përfaqësuesve ligjorë, për llogari të nxënësve, realizohet nga institucioni arsimor publik, për llogari të zyrës vendore të arsimit parauniversitar.

Likuidimi i faturës tatimore ndaj shtëpive botuese dhe/ose distributorëve realizohet nga zyra vendore e arsimit parauniversitar, me fondet e miratuara si 'Transfertë tek individët', në buxhetin e

ministrisë përgjegjëse për arsimin, në llogarinë bankare të shitësit.

Mënyra e shpërndarjes dhe e administrimit të teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi janë parashikuar në buxhetin e miratuar për vitin 2019 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 564, datë 31.7.2019

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR MBROJTJEN E VEÇANTË TË MAGJISTRATIT GJATË USHTRIMIT TË FUNKSIONIT OSE PËR SHKAK TË TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 20 të ligjit nr.96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Magjistratit i sigurohet mbrojtje e veçantë personale, e familjes dhe e pasurisë, sipas parashikimeve të këtij vendimi, kur, gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, i rrezikohet jeta, shëndeti i tij dhe/ose e/i familjes, si dhe pasuria. Mbrojtje e veçantë i sigurohet edhe magjistratit që nuk e ushtron funksionin ose që ka dalë në pension, në rast se e kërkon, në rast cenimi për shkak të ushtrimit të mëparshëm të funksionit.

2. Me mbrojtje të veçantë personale, të familjes dhe të pasurisë, sipas këtij vendimi, do të kuptohen masat me karakter organizativ e profesional, për sigurimin dhe ruajtjen e veçantë fizike, mbrojtjen e familjes e të pasurisë së magjistratit, si dhe masat e tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

3. Kushtet për të përfituar mbrojtje të veçantë janë, si më poshtë vijon:

a) Prania e rrethanave serioze, që rrezikojnë jetën, familjen ose pasurinë e magjistratit;

b) Prania e lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave serioze dhe ushtrimit të funksionit ose ushtrimit të mëparshëm të funksionit nga magjistrati.

Pavarësisht mungesës së lidhjes shkakësore të përcaktuar në shkronjën "b" të kësaj pike, magjistratit i sigurohet mbrojtje e veçantë edhe në rast të pranisë së rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pasurinë e magjistratit gjatë kohës që magjistrati ushtron funksionin e tij.

4. Kërkesa për mbrojtje të veçantë i paraqitet komisionit përkatës me shkrim nga magjistrati, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, ministri i Drejtësisë, kryetari i gjykatës ose drejtuesi i prokurorisë, ku magjistrati ushtron funksionin, si dhe çdo organ tjetër publik që, për shkak të funksionit, merr dijeni për praninë e rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pasurinë e magjistratit.

5. Kërkesa për mbrojtje të veçantë përmban:

a) gjenealitetet e plota të kërkuesit;

b) një përmbledhje të fakteve e të rrethanave, që përbëjnë rrezik serioz për magjistratin, të cilat detyrojnë të sigurohet mbrojtje e veçantë, si dhe burimin e provave, ku bazohen ato;

c) llojin e masave që kërkohen dhe kohëzgjatjen e tyre.

6. Kërkesa për mbrojtje i paraqitet Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas rastit, nga subjektet e përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, kur ka të dhëna të besueshme që provojnë se një magjistrati i rrezikohet jeta, familja ose pasuria.

Kur rreziku ndaj magjistratit është serioz dhe i çastit, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit urdhëron strukturat e Policisë së Shtetit të marrin masa të menjëhershme për të garantuar jetën, familjen ose pasurinë e magjistratit, deri në mbledhjen e komisionit. Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerëson masat e marra nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe vendos, kur është rasti, për vazhdimin e mëtejshëm të tyre.

7. Kërkesat për sigurimin e mbrojtjes së veçantë shqyrtohen, sipas rastit, nga Komisioni për Mbrojtjen e Gjyqtarëve, i cili ngrihet dhe funksionon pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ose Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve, i cili

ngrihet dhe funksionon pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me përbërje, si më poshtë vijon:

a) Një anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim, KLGJ) ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim, KLP), sipas rastit, me mandat dyvjeçar, të caktuar nga mbledhja plenare;

b) Një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, me mandat dyvjeçar, të caktuar me urdhër të titullarit të institucionit;

c) Një përfaqësues i Ministrisë së Brendshme, me mandat dyvjeçar, të caktuar me urdhër të titullarit të institucionit;

ç) Kryetari i Gjykatës ose drejtuesi i Prokurorisë, sipas rastit, pranë së cilës ushtron detyrën magjistrati, për të cilin kërkohet mbrojtje; në rastin e magjistratit, i cili nuk është më në detyrë kryetari i Gjykatës ose drejtuesi i Prokurorisë në detyrë ku ka ushtruar funksionin së fundmi magjistrati;

d) Një përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me mandat dyvjeçar me urdhër të titullarit të institucionit.

8. Kryetar i Komisionit për Mbrojtjen e Gjyqtarëve është përfaqësuesi i KLGJ-së dhe kryetar i Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve është përfaqësuesi i KLP-së. Në mungesë të tij, kryetari mund të autorizojë një nga anëtarët e tjerë të komisionit përgjegjës për thirrjen dhe/ose drejtimin e mbledhjes.

9. Kryetari i komisionit ushtron këto funksione:

a) Përgatit, thërret dhe drejton mbledhjet e komisionit;

b) Përfaqëson komisionin në marrëdhëniet me të tretët;

c) Siguron mbështetjen administrative dhe organizative nga këshilli përkatës për funksionimin e komisionit;

ç) Siguron dokumentimin e mbledhjes së komisionit dhe mbajtjen e dokumentacionit, në përputhje me legjislacionin për arkivat;

d) Ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi.

10. Kryetari, menjëherë pas marrjes së kërkesës për mbrojtje, njofton anëtarët e komisionit për mbledhjen e radhës. Komisioni duhet të mblidhet menjëherë dhe jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga paraqitja e kërkesës, sipas pikës 6, të këtij vendimi.

11. KLGJ-ja dhe KLP-ja sigurojnë mbështetjen e nevojshme organizative e administrative për realizimin e funksionit dhe të detyrave të komisionit përkatës.

12. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se katër anëtarë të tij. Vendimet janë të vlefshme kur miratohen të paktën nga tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

13. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij në mënyrë kolegjiale, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë vendim, të cilat, plotësohen, për aq sa nuk bie ndesh me dispozitat e këtij vendimi, nga rregullat e parashikuara në legjislacionin për organizimin e funksionimin e organeve kolegjiale. Pjesëmarrja në mbledhjet e komisionit është e detyrueshme. Kryetari i komisionit, në bashkëpunim më Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit, cakton një sekretar, nga radhët e nëpunësve të Këshillit, i cili mban procesverbalin e zhvillimit të mbledhjes.

14. Komisioni, në procesin e shqyrtimit të kërkesave për mbrojtje të veçantë të familjes e të pasurisë, sipas këtij vendimi, mund të kërkojë informacione nga institucione të tjera.

15. Komisioni merr në shqyrtim kërkesën e paraqitur dhe, kur bindet për nevojën e sigurimit të mbrojtjes për magjistratin, shprehet me vendim për të. Vendimi përmban masat konkrete të mbrojtjes së veçantë, numrin e shoqëruesve personalë, kur është rasti, afatin, brenda të cilit sigurohet mbrojtja, si dhe masa të tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

16. Vendimi i komisionit i njoftohet magjistratit nëpërmjet kryetarit të gjykatës ose drejtuesit të prokurorisë, ku ushtron funksionin, dhe strukturave përgjegjëse për mbrojtjen, nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Magjistratit, që nuk e ushtron funksionin ose që ka dalë në pension, i njoftohet vendimi i komisionit pranë vendbanimit të deklaruar.

17. Komisioni, me kërkesë të subjekteve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, kur ka të dhëna të besueshme që provojnë se një magjistrati i rrezikohet jeta, familja ose pasuria, mund të vendosë zgjatjen e afatit të masave të mbrojtjes, nëse rrethanat, për të cilat është siguruar më parë mbrojtja, vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të këtij afati.

Në rast se rreziku ndaj jetës, familjes ose pasurisë së magjistratit nën mbrojtje pushon së ekzistuari përpara përfundimit të afatit të mbrojtjes, sipas përcaktimit në vendimin e komisionit, me kërkesën e çdo subjekti të përcaktuar në pikën 4 të

këtij vendimi, komisioni mund të vendosë të ndërpresë mbrojtjen e veçantë të magjistratit.

18. Në rast se magjistratit i shkaktohen dëme për jetën, shëndetin, pasurinë e tij ose familjes së tij, gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, dëmet shpërblehen nga shteti, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

19. Vendimi nr. 480, datë 6.5.2009, i Këshillit të Ministrave, "Për mbrojtjen e veçantë personale, të familjes dhe të pronës së gjyqtarëve dhe për sigurimin e jetës e të pronës së tyre", shfuqizohet.

20. Ngarkohen ministri i Drejtësisë, ministri i Brendshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 565, datë 31.7.2019

PËR PËRCAKTIMIN E BUXHETIT FILLESTAR TË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 10, të nenit 57, të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar i përcaktohet për vitin 2019 buxheti fillestar prej 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve lidhur me ushtrimin e aktivitetit gjatë vitit 2019.

2. Ngarkohen Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen e procedurave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr.566, datë 31.7.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.22, DATË 12.1.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E KRITEREVE E TË PROCEDURAVE PËR CERTIFIKIMIN E VEPRIMTARISË SË AGROTURIZMIT DHE NDËRTIMIN E STRUKTURAVE/ OBJEKTEVE NË FUNKSION TË TIJ", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1, 2.2, 2.3, dhe 2.4, me këtë përmbajtje:

"2.1. Agroturizmi, si formë e veçantë e turizmit rural, është i orientuar drejt përdorimit të burimeve lokale të turizmit dhe ka si synim nxitjen e modeleve alternative të zhvillimit të produkteve turistike, nxitjen e prodhimit bujqësor/blegtoral, zhvillimin e zonave rurale, si dhe krijimin e një tregu të ri për produktet bujqësore/blegtorale.

2.2. Agroturizmi duhet të ofrojë njëkohësisht zotërimin e një ferme bujqësore/blegtorale, shërbimin e akomodimit, të ushqimit dhe të aktiviteteve rekreative.

2.3. Veprimtaria pritëse zhvillohet në fermat bujqësore/blegtorale, në të cilat ofrohen aktivitete të lidhura me prodhimin bujqësor/blegtoral, por duke mos cenuar mjedisin. Përfshirja e vizitorëve në aktivitetet e lidhura me fermën duhet të jetë me qëllim argëtues, edukues apo veprimtari të tjera të lidhura me mjedisin përreth.

2.4. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) "Strukturë/objekt akomodues në funksion të agroturizmit", struktura që vë në dispozicion të turistëve, vendas apo të huaj, individë ose të organizuar në grupe, shërbimet e akomodimit e të

pritjes dhe aktiviteteve rekreative në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë vendim.

b) "Fermë", njësia ekonomike bazë në bujqësi dhe në veprimtaritë ekonomike që lidhen me të. Ferma përfshin një sipërfaqe toke apo veprimtari që kryesisht i kushtohet prodhimit dhe menaxhimit të ushqimit ose prodhimit blegtoral.

c) "Certifikatë paraprake për veprimtari pritëse të certifikuar si agroturizëm" (në vijim referuar si "Certifikatë paraprake"), certifikata e lëshuar nga ministri përgjegjës për turizmin, bazuar në vendimmarrjen e komisionit vlerësues, për subjektet e reja të referuara në pikën 8/4 të këtij vendimi, që kanë marrë miratimin paraprak të projektidesë nga komisioni. Kjo certifikatë lëshohet për të bërë të zbatueshëm legjislacionin në fuqi për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

ç) "Certifikatë "Subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit" (në vijim referuar si "Certifikatë") është certifikata përfundimtare e lëshuar nga ministri përgjegjës për turizmin, bazuar në vendimmarrjen e komisionit vlerësues për subjektet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe pas regjistrimit të strukturës akomoduese pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.".

2. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Agroturizmi, si veprimtari, duhet të zhvillohet minimalisht në një nga fermat e mëposhtme:

a) Fermat bujqësore, të cilat kanë të paktën 1 ha tokë të mbjellë me kultura bujqësore;

b) Ferma blegtorale, të cilat mbarështojnë, të paktën, 10 krerë gjedhë ose 100 krerë dele/dhi ose 200 krerë shpendë;

c) Njësitë agrikulturore, të cilat kanë si aktivitet përpunimin e produkteve bujqësore, blegtorale, akuakulturës dhe që plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 6 dhe në shkronjat "a" e "b", të kësaj pike, të parashikuara në kreun II.".

3. Pika 5 shfuqizohet.

4. Në pikën 6, fjalët "… duhet të ofrojnë, minimalisht, njërin nga shërbimet e mëposhtme:" zëvendësohen me "… duhet të ofrojnë të gjitha shërbimet e mëposhtme:".

5. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"7. Struktura/objekti akomodues, në funksion të agroturizmit, duhet të ofrojë një kapacitet akomodimi nga 6 deri në 30 dhoma.".

6. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8. Struktura/objekti akomodues dhe pritës, në funksion të agroturizmit, duhet të respektojë:

a) kushtet e zhvillimit për ndërtim, të përcaktuara në planet e përgjithshme vendore ose në legjislacionin sektorial për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;

b) në varësi të llojit të strukturës/objektit, kriteret dhe kushtet e përcaktuara në vendimin nr.730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese", të ndryshuar;

c) atje ku është e mundur, karakteristikat/gjuhën arkitektonike të zonës.".

7. Pika 8/2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"8/2 Leja e ndërtimit lëshohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me dokumentin e planifikimit vendor në fuqi dhe legjislacionin sektorial për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.".

8. Në pikën 8/3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në shkronjën "d", pas fjalëve "Ministria përgjegjëse …" shtohen fjalët "… për turizmin …".

b) Në shkronjën "dh", fjalët "… në regjistrin e integruar të planifikimit të territorit." zëvendësohen me "… në sistemin e-leje.".

9. Pas pikës 8/3 shtohet pika 8/4, me këtë përmbajtje:

"8/4. Subjektet e reja, që kërkojnë të ndërtojnë një strukturë/objekt akomodues në funksion të zhvillimit të veprimtarisë pritëse të agroturizmit, duhet të marrin miratimin paraprak të projektidesë nga komisioni vlerësues, i ngritur pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin.".

10. Pikat 9, 10, 11 dhe 12 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"9. Subjektet që ushtrojnë veprimtarinë pritëse të agroturizmit, pasi të kenë përmbushur kriteret e përmendura në pikat 4 dhe 6 të kreut II, mund të ofrojnë edhe akomodim në formën e fushimit, me ambiente për vendosjen e çadrave apo të makinave të fushimit. Në këto raste subjekti garanton kushtet bazuar në vendimin nr.730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, për një kapacitet maksimal prej 15 makinash fushimi.

10. Struktura/objekti, ku ofrohet ushqim dhe pije, duhet të ketë 6 deri në 60 tavolina. Ofrimi i ushqimit dhe i pijeve bëhet në ambiente të

përshtatshme dhe duhet të plotësojë kriteret e parashikimeve të legjislacionit në fuqi për sigurinë e ushqimeve dhe kushtet higjieno-sanitare.

11. Ushqimi dhe pijet e ofruara në këto struktura duhet të jenë:

a) jo më pak se 30% të sasisë së tyre me origjinë nga ferma;

b) jo më pak se 40 % të sasisë së tyre, me origjinë lokale, brenda territorit të bashkisë ku ushtrohet veprimtaria e agroturizmit;

c) jo më shumë se 30% e sasisë së tyre me origjinë tjetër.

12. Subjekti që zhvillon veprimtarinë pritëse të agroturizmit duhet të ofrojë/mundësojë për vizitorët e turistët veprimtari argëtuese/çlodhëse, që lidhen me fermën dhe mjedisin përreth.".

11. Në pikën 13, fjalët "… dhënien e certifikatës "Subjekt i certifikuar agroturizmi" …" zëvendësohen me "… dhënien, pezullimin dhe/ose shfuqizimin e "Certifikatës paraprake" ose "Certifikatës"…".

12. Pas pikës 13 shtohet pika 13.1, me këtë përmbajtje:

"13.1. Komisioni vlerësues ka të drejtë, bazuar nga verifikimet e ndërmarra nga ana e tij, kryesisht apo në shkeljet e konstatuara nga organet përkatëse, të shqyrtojë dhe të marrë vendim për pezullimin dhe/ose shfuqizimin sipas rastit të "Certifikatës paraprake" si dhe "Certifikatës" sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t'u dëgjuar dhe për t'u ankuar.".

13. Pikat 14, 15 dhe 16 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"14. Brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj dispozite, ministri përgjegjës për turizmin dhe ministri përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural përcaktojnë, me urdhër të përbashkët, rregulloren e funksionimit të komisionit, si dhe procedurat e aplikimit, të vlerësimit paraprak dhe përfundimtar si dhe, sipas rastit, të vendimit për pezullimin dhe/ose shfuqizimin e "Certifikatës paraprake" apo të "Certifikatës".

15. Subjektet, që aplikojnë për marrjen e "Certifikatës paraprake" apo të "Certifikatës", paguajnë një tarifë prej 2 000 (dy mijë) lekësh në llogarinë e ministrisë përgjegjëse për turizmin. Të ardhurat nga këto tarifa derdhen në buxhetin e shtetit.

16. Bazuar në vendimmarrjen e komisionit, ministri përgjegjës për turizmin lëshon:

a) certifikatën paraprake "Për veprimtarinë pritëse të certifikuar si agroturizëm". Kjo certifikatë lëshohet për të bërë të zbatueshëm legjislacionin në fuqi për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe ka vlefshmëri deri në 2 vjet nga dhënia e saj;

b) certifikatën "Subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit". Certifikata lëshohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rinovimi, bazuar në kërkesën e subjektit.".

14. Në pikën 17, pas fjalës "Modeli i …" shtohen fjalët "… certifikatës paraprake dhe …".

15. Pas pikës 17 shtohen pikat 17/1 dhe 17/2, me këtë përmbajtje:

"17/1. Çdo subjekt i certifikuar për veprimtarinë e agroturizmit është i detyruar të përdorë në ambientet e tij, në një vend të dukshëm dhe në emërtimin tregtar shenjën dalluese, e cila miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për turizmin dhe ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

17/2. Të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e agroturizmit përfitojnë lehtësira fiskale sipas legjislacionit në fuqi, vetëm pasi të jenë të pajisur me "Certifikatën paraprake" ose "Certifikatën".".

16. Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"18. Në rast konstatimi të shkeljes së kritereve të këtij vendimi, organet përkatëse të bashkive, të inspektoratit të turizmit, organet tatimore ose organet kompetente të inspektimit të ushqimit dhe kushteve higjieno-sanitare, njoftojnë komisionin për shkeljet e konstatuara, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga konstatimi i shkeljes.".

17. Pas pikës 18 shtohet pika 18/1, me këtë përmbajtje:

"18/1. Shfuqizimi i certifikatës "Subjekt i certifikuar i agroturizmit" nga komisioni vlerësues, në rastin kur veprimtaria nuk përdoret për qëllime agroturizmi dhe subjekti ka përfituar lehtësira fiskale përjashtuese (si taksa infrastrukturës etj.), detyron subjektin që t'i kthejë këto përfitime. Përllogaritja bëhet nga organet tatimore/njësitë e vetëqeverisjes vendore.".

18. Pika 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"19. Subjektit, të cilit i pezullohet/shfuqizohet "Certifikata paraprake" ose "Certifikata", nuk mund ta përdorë atë në ambientet e tij ose në emërtimin tregtar. Subjekti mund të aplikojë sërish

për marrjen e "Certifikatës" në rast se plotëson kriteret e përcaktuara nga ky vendim.".

19. Në pikën 20, fjalët "… Subjekt i certifikuar agroturizmi …" zëvendësohen me "… Certifikatën paraprake" ose "Certifikatën"…".

20. Pikat 21 dhe 22 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"21. Subjektet që aktualisht kanë paraqitur aplikim pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj dispozite, të plotësojnë dokumentacionin sipas kritereve dhe kushteve të parashikuara në këtë vendim, për marrjen sipas rastit të "Certifikatës paraprake" apo "Certifikatës.".

22. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia e Zhvillimit të Territorit si dhe organet e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 567, datë 31.7.2019

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË BIBLIOTEKËS KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 8576, datë 3.2.2000 "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Piro Misha emërohet drejtor i Bibliotekës Kombëtare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2019-3641 (978), datë 3.7.2019, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Thoma Pandeli Lashi, më datë 19.2.2009.

KËRKESË

Shtetasja Mirela Skënderi kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen e ditës, muajit dhe vitit të vdekjes të personit të zhdukur, shtetasit Fatmir Isuf Skënderi, i datëlindjes 6.12.1963, duke përcaktuar datën 13.6.2008, si datë vdekjeje të tij.

KËRKUESE
Mirela Skënderi

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 476 lekë